



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIV i botimit, nr. 156, Tetor 2016
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

100 VJET AËRSIM DHE KULTURË NË DUKAGJIN

EKSPOZITA E PARË E PIKTURËS NË DUKAGJIN

Njeriu që nuk ka nevojë për një orë më zile; idetë e tija të mbajnë zgjuar gjithmonë

ME RASTIN E 85 VJETORIT TË LINDJES SË MJESHTRIT TË MADH, FADIL KRAJA -

8



Së pari ju përgëzoj për rubrikën "100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin". Jeni taman në kohën e duhur që kushdo të japë ndihmesën në këtë pjesë të jetës së kësaj zone, me kujtimet e veta të rëndësishme, sado që ngjarjet mund të jenë pasqyruar e të shpërndara në media të ndryshme të shtypit të kohës, por është tepër e vështirë me i kërkuar dhe përmbledhë për këtë rast. Mora dijeni nëpërmes gazetës "Dukagjini", të cilën e lexoj vijimisht, aq më tepër se me prejardhje jam edhe unë nga Mekshajt e Nën-mavriqit. Po përpiqem të kujtoj e të dokumentoj një ngjarje me të vërtetë të rëndësishme për kulturën në krahinën e Dukagjinit. Tue shfletuar ditarin më del se me datën 15 maj 1970, në zyrën e kulturës së Kom. Ekz. të k. p. të rrethit Shkodër, na mblodhën rreth 20 veta...

2

Një Premtim i Përmbushur!

KRONIKE MBI LIBRIN "PREMTIN I PËRMBUSHUR", TË AUTORIT GJON SINISHTA

9

Më datë 10 Tetor 2016, ora 18.30, në Sallën "Kardinal Mikel Koliqi", në kuadër të veprimtarive për Kanonizimin e Martirëve të Kishës Katolike në Shqipëri, Komisioni "Drejtësi dhe Paqe Shqipërisë" zhvilloi promovimin e librit "Premtimi i Përmbushur" të autorit Gjon Sinishta, përkthyer nga gjuha angleze nga Vladimi Banushi dhe mbështetur nga Organizata Katolike RENOVABIS-Freising, në Gjermani.

Të pranishëm ishin Arqipeshkvi, Mons. Angjelo Massafra, përfaqësues të Famullisë së Shën Shtjefnit dhe të famullive të tjera, përfaqësues të Komisionit "Drejtësi dhe Paqe" të kryesuar nga Kryetari z. Luigj Milla, përfaqësues të Radio Marisë, përfaqësues të Shoqatës "Projekti Shpresa", përfaqësues të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", përfaqësues të Grupit "Illiricum" të Kishës Françeskane e të tjerë, nga komuniteti dhe më gjerë.

Helmimi sociopsikologjik i fëmijërisë së hershme

BASHKËBËSEDIM ME SHKRIMTARIN LEKË IMERAJ -

6

Z. Lekë, ju në librat tuaj, vazhdimisht i keni kushtuar një vëmendje të veçantë rëndësisë së fëmijërisë së hershme, si udhërrëfyese për jetën e njeriut të ardhshëm. Parimisht keni theksuar se: Kush dhunohet, do të dhunojë. Të rinjtë e sotshëm, i referohem atyre që janë dhunues, mendoni se janë pasojë e një fëmijërie të helmuar psikologjikisht, me konflikte dhe dhunë?

Unë jam shumë i interesuar për ecurinë e adoleshentëve dhe kjo më shtyn që unë të jem vazhdimisht në kontakt, në forma të ndryshme, me shumë prej tyre, veçanërisht me ata që shfaqin prirje kriminale. Shumica e dhunuesve, që në fëmijërinë e tyre të hershme kanë përjetuar dhunë, nga prindërit, nga njerëzit, nga gjyshërit, nga vëllezëria e rritur, nga më të fortët e klasës dhe rrugës. Një pjesë e tyre, fatkeqësisht nuk dihet numri i saktë, kanë përjetuar edhe dhunë seksuale, deri në përdhunim.

100 VJET ARSIM DHE KULTURË NË DUKAGJIN

EKSPOZITA E PARË E PIKTURËS NË DUKAGJIN

Së pari ju përgëzoj për rubrikën "100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin". Jeni taman në kohën e duhur që kushdo të japë ndihmesën në këtë pjesë të jetës së kësaj zone, me kujtimet e veta të rëndësishme, sado që ngjarjet mund të jenë pasqyruar e të shpërndara në media të ndryshme të shtypit të kohës, por është tepër e vështirë me i kërkuar dhe përmbledhë për këtë rast.

Mora dijeni nëpërmes gazetës "Dukagjini", të cilën e lexoj vijimisht, aq më tepër se me prejardhje jam edhe unë nga Mekshajt e Nënmaçiqit.

Po përpiqem të kujtoj e të dokumentoj një ngjarje me të vërtetë të rëndësishme për kulturën në krahinën e Dukagjinit. Tue shfletuar ditarin më del se me datën 15 maj 1970, në zyrën e kulturës së Kom. Ekz. të k. p. të rrethit Shkodër, na mblodhën rreth 20 veta të profesioneve të ndryshme si piktor, dekorator, muzikantë, mjek, infermier, ekonomistë, e të tjerë. Ky ishte ekipi që do të shkonte në Dukagjin për të përgatitur gjithçka duhej për një seminar kombëtar që do të zhvillohej në atë zonë. Rruga ishte e zanun nga bora e makina në çoj deri në Okol të Bogës, mandej do të ecnim në këmbë nëpër borë nga Qafa e Tërthores, e teposhte në Ndërlýsë e në Breglumi.

Rreth tri javë që më takoj me ndejë aty, mbasi semiari u shty për më vonë, unë shfrytëzoza rastin e punova një seri vizatimesh dhe akuarelesh që më bënë të mendoj për një ekspozitë personale aty, në Breglumi.

Mbasi kisha punuar, përveçse në Breglumi edhe në Gimaj, Abat, Pecaj, Nicaj, Lotaj Kodërshëngjergj, me 11 qershor u ktheva në Shkodër ku i përgatita thjeshtë me ndonjë pas-paltim, për një ekspozitë, dhe me datën 19 karrik 1970, ditë e dielë, në mjediset e shtëpisë së kulturës në Breglumi, hapa ekspozitën me pamje nga jeta, puna dhe natyra në këtë zonë.

Ishte e para ekspozitë e arteve figurative që hapej ndonjë herë në Dukagjin. Përshtypjet ishin tepër të mira e të përzemërta nga vizituesit



e malësisë, të etshëm për kulturën.

Pata rastin që në këtë kohë, të qëllonte në Breglumi ministri i arsimit dhe kulturës, Thoma Deljana, i cili e vizitoj dhe më përgëzoj për iniciativën që kisha marrë. Fjalët e ngrohta, të thjeshta, por të sinqer-ta të malësorëve më dhanë forca për punë të mëtejshme me temën e malësisë, duke u mbështetur në bisedat e pleqëve dhe të rinjëve.

Për këtë ekspozitë, gazeta lokale e Shkodrës "Jeta e Re" botoj një artikull me datën 29. 7. 1970. Më vonë me këto punime hapa ekspozitën "Përshtypje nga Dukagjini" në shtëpinë e kulturës së qytetit të Shkodrës.

Më vonë kamë çuar rrethin e pikturës, që ishte pranë shtëpisë së kulturës së Shkodrës, të cilin e drejtoja, në Dukagjin dhe me punimet e tyre hapa një ekspozitë që ishte edhe kjo e para e kësaj natyre me punime të bërë nga rrethi i pikturës, po në shtëpinë e kulturës në Breglumi.

Piktori Pjerin Sheldia

MESAZHURIM I KRYESISË SË KOMITETIT TË VETERANËVE TË LANÇ TË RRETHIT TË SHKODRËS

DREJTUAR: SHOKUT MIRASH NDREZAJ, ME RASTIN E 90 VJETORIT TË LINDJES

I dashur shoku Mirash!

Me rastin e 90 vjetorit të lindjes suaj, Kryesia e Komitetit të Veteranëve të LANÇ të rrethit Shkodër, në këtë ditë gëzimi, ju sjellim juve personalisht dhe familjes tuaj, urimet me të përzemërta. Jete te gjate, shëndet dhe lumturi në familje.

Juve shoku Mirash, bir i një familje me ndjenja të larta patriotike dhe nga urrejtja për pushtuesit fashist dhe mercenaret e tyre qyshe nga janari i vitit 1944 u aktivizuat në LANÇ si një luftëtar i vendosur, fillimisht në terren e pak me vone si partizan i Batalionit "Perlat Rexhepi", duke treguar guxim deri në çlirim e plote të Shqipërisë, me 29 nëntor 1944. Pas çlirimit të vendit, në janar 1945 shërbyet në komandën e vendit në Kodër-



Shëngjergj të Dukagjinit e me pas në Mirdite dhe në Divizionin e Mbrojtjes së Popullit, në Tiranë.

Pas kësaj periudhe në shërbim të Atdheut me devotshmëri të larte në ushtri, kërkesa dhe dëshira e juaj

për të kaluar në sektorin e arsimit realizohet. Ndërkohe në saj të këmbënguljes tuaj përfunduat me sukses arsimin e lartë në degën Bio-Kimi. Si arsimtar keni dhënë kontribut të madh për edukimin e brezit

betë një intelektual i nderuar e atdhetar duke dalë në pension shume i nderuar dhe i respektuar nga të gjithë.

Për merita lufte dhe pune juve u janë akorduar disa medalje.

Me pas ju u aktivizuat shpejt në Organizatën e Veteranëve të rrethit ku kontributi i juaj ka qenë i rëndësishëm në mbrojtje të idealeve të LANÇ-it dhe transmetimin e tyre në brezin e ri të pasardhësve.

Edhe një here urimet tona me të përzemërta shoku ynë i nderuar dhe i respektuar Mirash Ndreza.

PËR KRYESINË E KOMITETIT TË VETERANËVE TË LANÇ TË RRETHIT SHKODËR
Sekretari - Agim Peci
Kryetari - Vehbi Fishta

Me pas ju u aktivizuat shpejt në Organizatën e Veteranëve të rrethit ku kontributi juaj ka qenë i rëndësishëm në mbrojtje të idealeve të LANÇ-it dhe transmetimin e tyre në brezin e ri të pasardhësve.

Edhe një here urimet tona me të përzemërta shoku ynë i nderuar dhe i respektuar MIRASH NDREZAJ.

PER KRYESINË E KOMITETIT TË VETERANËVE TË LANÇ TË RRETHIT SHKODËR.

Sekretari:

Agim Peci



Kryetari:

Vehbi Fishta

te ri të zonës së Dukagjinit që ju lindi, ju rriti dhe u

AHENGU SHKODRAN 2016

PËR TË KATËRTIN VIT RADHAZI ERDHËN ME INTERPRETIMIN E ZËRAVE TË RINJ PERLA TË KËNGËVE ME TË CILAT KY QYTET KA VENDOSUR NJË GUR TË ÇMUAR NË KULTURËN SHQIPTARE



Ramazan ÇEKA
Shtator 2016

Koncerti i përvitshëm me këngë të zgjedhura nga repertori i pasur i këngës popullore shkodrane është një aktivitet, jo thjesht argëtues, por ka si qëllim që trashëgiminë e pasur shpirtërore të këtij qyteti ta ruajë e përçojë ndër breza duke e risjellë atë magjishëm vit pas viti si një perlë të "Ahengun Shkodran", por edhe si pasuri të madhe të kulturës shqiptare.

Ishte një natë magjike, sepse i tillë është edhe "Ahengu Shkodran". Kënga dhe muzika mbushi mjediset e lulëzuara të oborrit karakteristik të shtëpisë muze "Oso Kuka", me tigujt e mrekullushëm, me djem dhe vajza të bukura dhe të talentuar, të veshur me kostume karakteristike të qytetit, të cilët për rreth dy orë, sollën para publikut një buqetë këngësh, pjesë nga repertori i pasur i "Ahengut Shkodran".

Risia krejtësisht e veçantë e kësaj mbrëmjeje ishte se këto këngë, sa të bukura, aq edhe të vështira, u interpretuan nga këngëtarë të ri, zërat më të zgjedhur e më të afirmuar të qytetit të Shkodrës, të cilët janë vlerësuar dhe na kanë ndëruar edhe në evente kombëtare si: festivalet të ndryshme, "Talent show", "X-Factor", "Gjeniu i vogël", etj. dhe që tani me duartrokitjet e publikut shkodran morën një vlerësim mbështetje të fuqishme.

"Ahengu Shkodran" është edhe një eksperiencë e jashtëzakonshme vlerash e vlefshme për të gjithë pjesmarrësit, sidomos të rinj.

Për të katërtin vit radhazi erdhën me interpretimin e zërave të rinj perla të këngëve me të cilat ky qytet ka vendosur një gur të çmuar në krijimtarinë shekullore të muzikës popullore qytetare.

Organizatorët me aktivitete të tilla synojnë që ta ruajnë këtë traditë, por edhe ta kultivojnë tek brezi i ri, të cilët duhet të jenë pasuesit e denjë të interpretuesve të paharruar të këngës së bukur shkodrane.

Përveçse kënaqësi, organizimi në këtë mënyrë ishte edhe përgjegjësi, sepse aty brezi i ri i këngëtarëve, interpretonte para një brezi pak më të "vjetër" që me siguri ishte aty edhe për t'i dëgjuar me kënaqësi, por edhe për t'i vlerësuar e këshilluar, sepse realisht nuk është e lehtë të këndohet kënga shkodrane ashtu siç e kanë kënduar ata dhe brezat para tyre.

Dhe natyrisht kënaqësia më e madhe ishte për ata këngëtarë të rinj që merrnin

pjesë për herë të parë në "Ahengun Shkodran" dhe të cilët ishin jo pak, por rreth 20 këngëtarë. Ata u ngjitën në skenë të shoqëruar nga orkestra profesioniste e Teatrit "Migjeni": Anton Kaftalli në violinë, Namik Jahja, klarinetë, Fatmir Mesi, dajre, Kujtim Tuzi, kontrabas, Myrteza Dibra, kitarrë me drejtues orkestre maestro Ilir Zoga.

Zërat e bukur, të freskët e rinorë sollën në këtë bahçe me lule një copëz pranverë. Jehona e këngëve përplasej në avullitë e larta të oborrit, hynte përmes shkallëve të gurta në çardakun e madh dhe pasi shëtiste shtëpinë rikthehej në oborr nëpërmjet penxhereve kafazlije.

Të krijohej kështu ndjesia, se në këtë shtëpi po bëhej një dasëm e madhe shkodrane. Këtë e evokonin si në një pikturë të Idromenos edhe kostumet tradicionale popullore.

Ata që për shumë vite i kënduan këto këngë dhe i përcollën tek brezi i ri, në këtë mbrëmje ishin të shumtë. Kishin ardhur aty për të shijuar zërat e më të rinjve të skenës, pasardhësve të tyre të denjë.

Në këtë natë u kujtuan me respekt edhe këngëtarët e famshëm shkodranë, që para pak kohësh u ndanë nga jeta: Bik

Ishte një kënaqësi e madhe të dëgjoje Ahengun e bukur Shkodran, që me të drejtë është cilësuar si një ndër shtatë kryeveprat e trashëgimisë kulturore shqiptare.

Në Shkodër ka shprehje të veçanta për ahengun shkodran si: "Ju shkoftë jeta me aheng!", sepse ahengu nënkupton gëzim, hare, emocion, pasion, mall, meditim, gjithçka e shprehur në larminë e këngëve që dikur janë kënduar sipas një rregulli të caktuar për orë dhe ditë të tëra pa përsëritur dy herë të njëjtën këngë.

Edhe këtë natë ishte krenari që u sollën copëza nga kjo trashëgimi e vyer.

Krenohemi me Palokë Kurtin, këtë reformator të parë të muzikës së kultivuar shqiptare. "Jaret" e famshme të krijuara prej tij me interpretimet e Marie Krajës dhe artistëve të tjerë do të konsideroheshin me të drejtë si "Arie" për nga mjeshtria e ndërtimit dhe interpretimit.

Në "Ahengun Shkodran" kush këndonte "Jaret" klasifikohej këngëtar i vërtetë, sepse ata duhej të këndoheshin në "Zyl hava", sipas modelit të "Ahengut të vjetër".

"Pse ti lule rrin e mshehun" ishte kënga që hapi këtë natë, kënduar nga këngëtar-

vlerësonin këngët që duhet të hynin në "Aheng".

Për të ruajtur këtë traditë të trashëgimisë dhe pasurimit të repertorit popullore shkodran, në muajin nëntor do të organizohet nën kujdesin e Bashkisë së Shkodrës dhe nga Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" Festivali i Këngës Shkodrane me krijimtarë të re.

Bashkia Shkodër meriton një falenderim të veçantë për mbështetjen e këtyre aktiviteteve të rëndësishme.

Një tjetër këngëtar me ndjeshmëri artistike Ademir Fresku, student në Akademinë e Arteve, me jaren shkodrane "Qenke nuri i bukurisë" korri duartrokitjet e publikut me interpretimin e tij të ngrohtë.

Interpretimi i këngës "Tri vjet që u deshtme bashkë" nga këngëtarja simpatike Ketlin Pjalmit, krijoi atmosferë dhe emocion tek spektatorët e pranishëm të cilët i dhanë asaj vlerësimin e merituar.

Të pranishëm në këtë koncert ishin edhe personalitete të artit e kulturës në Shkodër si: Kryetarja e Bashkisë znj. Voltana Ademi, shkrimtari dhe dramaturgu i shquar Fadil Kraja "Mjeshtër i Madh", këngëtarja Bujar Qamili "Mjeshtër i Madh", këngëtarja Mukades Çanga, Drejtori i Qendrës Kulturore të Ulqinit Prof. dr. Nail Draga e të tjerë.

Vlerësim për aktivitetin solli në fjalën e tij edhe "Mjeshtër i Madh" Bujar Qamili, i cili vuri theksin në punën e madhe që bëhet me këngëtarët e rinj, por në mënyrë të veçantë ai vlerësoi edhe sipërmarrjen e Bashkisë Shkodër, Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" me drejtor Sidrit Lohja dhe me drejtues artistik Bardhyl Hysa, si dhe Teatrin "Migjeni" me maestro Ilir Zoga që janë angazhuar për organizimin e festivalit me krijime të reja.

Një aktivitet i tillë, vuri në dukje ai, që do të organizohet në Shkodër në nëntor të këtij viti, nuk e di nëse bëhet edhe në ndonjë qytet tjetër, kuptohet me këngëtar të rinj.

Bujari theksoj që, mbas brezit të parë si; Marie Kraja, Bik Ndoja, Luçie Miloti, Naile Hoxha, Xhevdet Hafizi, Ibrahim Tukiqi, Shyqyri Alushi etj. jemi ne brezi i dytë si; Bashkim Alibali, Valdete Hoxha, Vjoleta Zefi, Mukades Çanga, Enriketa Kuqani, Adnan Bala, Hajro Pepa etj. Ndaj dëshiroj dhe uroj që ky grup këngëtarësh të rinj të jetë brezi i tretë i këngës popullore qytetare, sepse kjo tregon që Shkodra është burim i pashtershëm i talentëve që ruajnë dhe interpretojnë me dashuri këtë këngë.

E rëndësishme, tha Bujari, është që organizohet një event i tillë, duke uruar këngëtarët për suksese në karrierën e tyre artistike, por dhe duke i këshilluar ata që të ndjekin brezin e këngëtarëve të vjetër. Në përfundim të fjalës së tij Bujar Qamili tha se sonte janë të gjithë këngëtarët fitues.

Drejtimesja e talentuar e këtij eventit Gentjana Dani falen-



Ndoja dhe Naile Hoxha, artistë të cilët kanë kontribuar në vite për këngën e bukur shkodrane. Porosia e tyre e paharruar për brezin e ri ishte: "Këngën shkodrane duhet ta këndonin pastër dhe bukur, pa deformime të tepërta, i gjithë trupi dhe mimika juaj duhet të transmetojë atë ç'ka ju ndjeni".

Në vitin 1961 u organizua për herë të parë në Shkodër festivali i parë i këngës, i cili në atë kohë drejtohej nga mjeshtri krijues dhe instrumentisti i paharruar Mark Kaftalli, i cili në krijimtarinë e karrierës e tij na ka lënë mjaft këngë të kompozuar që kanë hyrë në fondin e artë të këngës popullore shkodrane. Falenderimet i shkojnë dhe trashëgimtarit të tij Anton Kaftalli.

ia e re Xheni Palushaj.

Dy këngë të tjera shumë të njohura të titulluara: "Marshalla bukurisë tande" dhe "Moj e vogël si flori" u interpretuan me plot mjeshtri nga djaloshti simpatik Lorjan Ejlli.

Mund të themi pa hezitim se në Shkodër dëgjon këngë të bukura, shikon kostume të bukura popullore me vlera të veçanta etnografike, por mbi të gjitha mëson edhe shumë gjëra të bukura për "Ahengun Shkodran", apo organizimin e tij që në zanafillë. Mëson për "Redin e Odave" të dikurshme që ishte një lloj festivali për krijime të reja, të cilët organizoheshin në çardaqtë e shtëpive shkodrane, ashtu siç ishte edhe kjo natë, ku përveç artistëve merrnin pjesë edhe dëgjues që

Ç'ESHIE BËRË E Ç' BËHEI NË EMRIN TËNDE O POPULL?



Po të duash me hedhë veshtrimin nga e kaluara, me siguri që do të kujtohen të mirat dhe të metat. Një pjesë i ke marrë nga historia, pjesen tjetër mbase i ke jetuaur. Populli thotë se njëqind të mira harrohen dhe një e keqe nuk harrohet. Po kur ndodh e kundërta, se është një e mirë dhe njëqind të këqia, ato rëndojnë shumë, në llogaritë edhe peshën specifike të ndodhive. Ato që kanë peshë të madhe, ato të stërmundojnë. Secili regjim që ka kaluar në vendin tone ka lënë gjurmë diku për mirë e diku për keq. Por kjo e dyta duket se ka qënë dominuese. Kur krahasohemi me fqinjët tonë ose vende të tjera të Evropës e kuptojmë sa prapa kemi mbetur. Kushtet gjeografike, klimaterike e gjeofizike rradhë i gjenë si në Shqipëri. Duke mos pasur qëllim në këtë shkrim historinë, po ndalemi pas viteve 1944. Të gjitha reformat e bëra u kryen me propogandën, “Në emër të popullit!”. Po kush e pyeti popullin e shkret. Për vendosjen e diktaturës se proletarietit, për shtetëzimet, për instalimin e luftës së klasave, për kolektivizimin e bujqësisë, për luftën kundër besimeve e prishjen e kulteve fetare e të tjera, e të tjera.

Nuk e shohë të arsyeshme të ndalemi më tepër për atë periudhë. Të kthehemi në vitet e demokracisë. A nuk ishte një votë pebleshtarë ajo e 22 marsit të vitit 1992, për permbyshjen e diktatures komuniste dhe vendosjen e demokracisë.

Po, ishte populli ai që nuk pranoi projekt Kushtetun e vitit 1994, ashtu siç nuk pranoi kalimin e drejtimit nga republikë në monarki. Pra, populli gjithnjë merr vendime të drejta. A nuk ishte një referendum, reagimi i qytetareve kundër importit të mbetjeve kimike. Ky reagim bëri që të anulohet importi i tyre. Pse, ne kemi frikë nga referendimet? Kësaj pyetje, pergjigje i jep edhe më naivi. Dihet se, referendimet nuk ju pëlqejnë pushtetarëve. Vendimet i marrin e pastaj i propogandojnë për të mirat gjoja të tyre. Këto 25 vite në demokraci, janë marrë vendime të dyshimta, pa transparencë, madje kanë renduar në kurrizin e këtij populli, i cili po i shtrembërohet për ditë nga padrejtësitë e pushtetarëve pavarësisht se kush ka drejtuar në këto 25 vite.

Demokracia e paster buron nga rrënjët e vullnetit historik të popullit. Një demokraci e tillë jo vetëm e jetës politike, por edhe e sistemit politikë e shoqëror. Por duhet bërë kujdes për të mos lejuar që hallkat e pushtetit të bien në duarët e vetme të një pushtetari. Siç nënvizon tepër qartë mbi ndarjen e pushtetit, filozofi dhe shkrimtari politikë francez Charles Montesquieu se “Çdo gjë do të ishte e humbur, në rast se një person, apo bashkimi i të njëjtëve persona të mëdhenje do të ushtronin të gjitha pushtetet, pushtetin e leshimit të ligjeve, zbatimin e vendimeve publike dhe gjykimin e krimeve apo të konflikteve”. A nuk ka pasur raste, madje të shumëta të pushtetarëve tanë, për të kapur të gjitha institucionet? Të gjithë jemi deshmitar, se ka pas dhe ka, ku mbi interesat e popullit vejnë veton dhe interesat e tyre. Reformat e bëra kanë përmirësuar klimën në vendin tonë. Të tilla janë bërë disa, ku mund të veçojmë reformat në energjitikë, reforma territoriale, reforma për mbrojtjen e territorit nga ndertimet e pa ligjshme. Përsëri më ngelet merak se, reforma territoriale mund të organizohet me referendum. Duke paraqit dy variantet me 61 dhe 90 njesi vendore. Me siguri se populli është

gjykatësi më i mirë. Rast i rradhë po me konsensus u miratua reforma në drejtësi. Këmbënguli fortë te konsensusi i të gjithë faktorëve politikë. Pa dyshim kjo është një arritje e politikës Shqipëtare.

Përpara politikanëve të vendit tonë, qendrojnë shumë sfida. Më kryesorja është reforma zgjedhore, e cila kerkonë mirkuptim nga të gjitha partitë politike, si nga ato parlamentare dhe nga ato jashtë parlamentit. Racionale ishin propozimet e LSI. Pse heshtën dy forcat kryesore të politikës dhe nuk u prononcuan! Mendoj se ka vëndë për të permirsuar kodin zgjedhor. Konkretisht numri i deputetëve duhet kufizuar, duke ulur shpenzimet e taksas paguesve. Vendosija e numrit të deputetëve, jo më shumë se 100 deputet. Pra, më pakë 40 deputet, duke llogaritur vetëm pagën vjetore, popullit i kursehen 120 000 000 lekë. Sikur këto të ndahen propocianalisht pensionistëve të vendit, të cilëve me pensionet aktuale me vështirësi marrin barnat, që ka qënë dhe është shtresa më e varfër.

Në parlamentin e sotëm ka rreth 40 deputet, që nuk kanë diskutuar, madje një perditshme i quajti “deputet memec”. Parafatyro se si i çojnë zerin e elektoratit në kuvend. Janë vetem me ngritë kartonin si ti thotë kryetari. Zgjedhjet e ardhëshme duhet të bëhen me lista të hapura. Kandidatët duhet të kalojnë në sitën e subjektit, por edhe të elektoratit, i cili duhet ta dij se, kush është personi, të cilit i besojmë përfaqësimin në instancën më të lartë. Kjo do ju heq të drejtën kryetarëve të partive, të vendosin në lista, si t’iu doje kalem i atyre. Pastaj të thonë se kështu e do populli. Vendi jonë ka intelektual, me tituj e grada shkencore e me inegritet. Pse të propozohen biznesmen?! Pergjigjia është e thjeshtë. Biznesmenet hedhin para për fushatë, blejnë votat. Fiton subjekti që ka më shumë biznesmen. Pasi subjekti fiton zgjedhjet, vihen në jetë marrëveshjet parazgjedhore. Duke ju dhënë të gjitha tenderat pa konkurim, vetëm tu kthejnë reston. Kalimi me lista

të hapura në kondidimin për deputet, do sfidonte subjektivizmin në zgjedhjen e individve. Të cilët më mirë se kushdo tjetër i njeh ambjenti ku punojnë e jetojnë, qëndrimin e tyre dhe të familjeve të tyre. Kandidatët të kenë mundësi të përballen me idet e programet e tyre në elektorat. Fenomen tjetër është korektimi i votave i cili duhet bërë në shkallë kombëtare. Pra, votat për subjektin duhet të jenë si në Vermosh edhe në Konispol. Kjo do sillte prurje të reja në parlament edhe nga partit e vogla, që kanë elektorat në të gjithë vendin. Mbase do arrihej të krijohej edhe një pol i tretë në politikën Shqipëtare.

Le të kthehemi përsëri te titulli shkrim-it, duke mbeshtet fortë verdiktin e popullit. Ç’të keqe ka të mbahet referndumi, për reformen zgjedhore po qe se nuk realizohet me konsensus, per importin e mbetjeve e të tjera. Populli ta thotë fjalën e tij te kutia e votimit. Ashtu si duhet të pyetet populli për shumë probleme të tjera. Po kështu edhe për zgjedhjen e Presidentit, kjo do jepte vendin që i takon Kryetarit të Shtetit, qoftë edhe me ato pak kompetenca që i janë lënë. Do të ishte mire që edhe për konçensionet të merrej mendimi i popullit. Jepen konçesione për ndertimin e HEC-eve mbi lumin Vjosë, Valbonë, Shalë e të tjera. Këto pasuri të rëndësishme që jua ka falë natyra po ti shkatërrojme, brezat që do të vijnë do të na gjykojnë rëndë pa marrë mendimin e popullit të atyre zonave. Pse të mos bëhen referndume rajonale. Referndumi për ndertimin e hidrocentraleve mbi lumin e Valbonesë, pasi populli i kësaj zone të jetë shprehur, atëherë të vazhdojnë preçedurat për dhënjën me konçension për ndertimin e tyre; dhe të mos ndodhe, që banorët e këtyre zonave të njihen me këto konçension, pasi janë bërë fakte të kryera. Kjo nuk bie erë të mire!

Pra, kur populli miraton ato projekte, që ju janë paraqit, atëherë do themi se, këto veprime janë bërë në emrin tëndë, O POPULL!
NDUE ZIÇI

deroi edhe mësuesen e kantos znyj, Rita Dervishi në Shkollën e Mesme Artistike “Prekë Jakova” për kontributin dhe punën e vazhdueshme profesionale e të palodhur me këngëtarët e rinj.

Një nga këngët që ka kënduar Naile Hoxha titulluar “Djal’ i dashtun” u interpretua me shumë pasion nga këngëtarja e re Klodiana Vata.

Edhe pse janë të rinj Adelina Corraj dhe Klinsman Llazani kanë një repertor të gjërë të këngës popullore shkodrane, ata dinë mbi 100 këngë.

Adelina Corraj performoi me këngën “Iptida për t’paren herë”, duke vazhduar me Klinsman Llazanin, student në pedagogji muzikore, me këngën “Po ta marr’ kangen me saze”, që gjatë interpretimit

pati shumë duartrokitje nga të pranishmit.

Ishte këngëtarja e talentuar nga Ulqini Egzone Salaj, nxënëse në Shkollën e Mesme Artistike “Prekë Jakova”, njëkohësisht edhe fituese e çmimit si këngëtarja më e mirë e Festivalit Kombëtarë në Gjirokastër, e cila performoi me këngët “Shegë e ambël” dhe “Gocë e vogël ndej n’lëndinë”.

Aktivitetin e mbylli një vajzë që na ka bërë të gjithëve krenarë me talentin dhe paraqitjen e saj dinjitoze tek “Gjeniu i vogël”, edicioni i fundit, Marjana Begu, një zë i vërtetë engjëllor.

Me këngët “Pranvera filloj me ardhë” dhe “Bishtalecat palë-palë” ajo mahniti publikun.

Bardhyl Hysa në intervistën që i

morëm tha: “Kemi krijuar si një Akademi të Artit nga Qendra Kulturore e fëmijëve që mundësisht mos t’i lëmë pa i ndihmuar, por t’i ofrojmë skenën, t’i ofrojmë këngën popullore. Bardhi theksoi se ndër 22 këngë që keni dëgjuar sot, kur kemi filluar provat, këngëtarët e rinj nuk kanë ditur më shumë se një ose dy këngë. Pra kjo është një pasuri dhe kjo është kënaqësia dhe emocioni që ndjeje unë për këtë mbrëmje”.

Kryebashkiakja Voltana Ademi tha se “Shkodra din të flasë me gjuhën e artit dhe kulturës dhe pas Ahengut do të sjellim në muajin nëntor Festivalin e këngës qytetare me interpretime të reja, duke rikthyer një traditë që na ka munguar prej vitesh. Shpresoj shumë, tha ajo ndër të tjera, që me këta aktivitete ne mund të

përtrijmë sa më shumë atë që ne shpesh edhe e harrojmë, qytetërimin dhe atë çfarë përfaqëson Shkodra”.

Për ta ruajtur këtë traditë të pasurimit të repertorit popullor shkodran, në muajin nëntor do organizohet nën kujdesin e Bashkisë dhe Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci” Festivali i Këngës Shkodrane, me krijimtari të re.

Në Shkodër të gjithë këndojnë, është ky një citim i studiuësit shkodran Isa Alibali, që në qytetin e artit dhe kulturës ka gjetur vend më së miri dhe që po dëshmohet çdo vit me të tilla organizime të Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci” dhe Bashkisë së qytetit.

Pritet që koncerti “Ahengu Shkodran 2016” të jepet një natë në Ulqin dhe një natë në Gjakovë.

CEREMONI E BUKUR FESTIVE NË ROMË

25 VJET MARRËDHËNIE DIPLOMATIKE MIDIS SHQIPËRISË DHE SELISË SË SHENJTË, VATIKAN



Shqipëria në vitin 1976 doli hapur si vend ateist. Shembja e kulteve fetare ishte përfundimisht shkatërrimi i kulturës dhe identitetit. Komunizmi dhe diktatori Hoxha vranë dhe persekutoan kryesisht klerikët katolike.

Në Shqipëri u mbyllen 2169 kisha dhe xhamia, sipas statistikave të asaj kohe ... Në Shqipëri ishin 7 ipeshkvi me rrethe 200 priftërinj e mbi 200 murgës, që janë në librat e arkivave të vitit 1945. Gjate tragjedisë komuniste arritën t'i mbijetojnë regjimit 1 ipeshkvi e 30 priftërinj dhe një numër shumë i vogël, aty te tridhjetë murgës.

Selia e shenjte e Vatikanit u trondit nga këto veprime monstruoze gjakatare. Vatikanit u përpoq të ndërmjetësonte me Qeverinë e asaj kohe të Shqipërisë, por çdo tentativë ishte e kote.

Për fat të mirë erdhi viti i lirisë dhe i demokracisë. Aty, në fillim të viteve '90, të cilat sollën dritën e Diellit dhe bekimin e Zotit për Shqiptarët, lindi liria e fjalës dhe e besimit. Njerëzit rinisen t'i gëzoheshin jetës që i priste në të ardhmen.

Qeveria e asaj kohe, filloi menjëherë kontaktet me Selinë e Shenjte, në Vatikan. Fillimi i kontakteve me Nënë Terezës, me vizitat e saj të shpeshta, ndikuan për mirë tek selia e Shenjtë e Vatikanit. Çimentohen marrëdhëniet diplomatike midis Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të Vatikanit. Ambasadori i parë i Shqipërisë në Vatikan, në vitin 1992 emërohet z. Wili Kamsi, i cili pati nderin të pritej nga Shenjtëria e Tij, Papa Gjon Pali i II, me rastin e letrave kredenciale.

Në vitin 1996 emërohet ambasadore z. Pjeter Pepa, i cili u zëvendësua në vitin 1997 me z. Jul Bushati. Në vitin 2002 emërohet ambasadore z. Zef Bushati. Nga viti 2006 e në vijim është ishte ambasador z. Rrok LOGU.

Selia e Shenjte akreditonte në Shqipëri, në vitin 1992 Nuncin e parë Apostolik, Imzot IVAN DIAS (sot Sardinia). Në vitet 1997 Nuncin Imzot GIOVANNI BULAITIS. Në vitin 2008 Nuncin Apostolik Imzot Ramiro Mliner Ingles. Vendosija e marrëdhënies diplomatike në mes të Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë është rreze drite, shprese e zhvillimi.

Data 25 prill 1994 është një date që historia Shqiptare e ka skalitur në memorien e saj. Tokën Shqiptare e puth sapo zbret në aeroportin e Rinasit, Papa Gjon Pali i II. Një pritje madhështore, e paharruar. Mesha e Shenjtë në Katedralen

e Shkodrës ishte një hapje horizonti për një popull të shtypur që donte paqen, fenë dhe jetën.

Papa insistoi në emërimin e 30 kardinalëve të rinj, që në mes tyre ishte dhe emërimi i kardinalit 92 vjeçar, MIKEL KOLIQI; ishte vlerësimi, që Papa i bëri këtij kleriku të dënuer për 38 vite burgjeve komuniste. Diplomacia e Selisë së Shenjtë te Vatikanit është i shpërndarë në 178 shtete të botës. Ka mbi 43 organizata të ndryshme ndërkombëtare me status të plote dhe atë të vëzhguesit të përhershëm. Marrëdhëniet e shëndosha në mes Qeverisë Shqiptare dhe Selisë së Shenjtë kanë qenë shumë të dobishme, ku janë nënshkruar një seri marrëveshesh dypalëshe.

Në fushën e mjekësisë, Selia e Shenjte ka nënshkruar kontrate me Ministrinë e Shëndetësisë të Shqipërisë në fushën e kërkimore-spitalore "Bambino Gesu", në vitin 2010 Poliklinika Universitare "Agostino Gemelli" në Romë. Gjithashtu, në prill të vitit 2011 është firmosur protokoli i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Operas Pellegrinaggi. Marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Vatikanit dhe qeverisë shqiptare janë zgjeruar si në fushën e shëndetësisë, arsimit, kulturës e deri në sigurimin e ndihmave materiale sanitare dhe ushqimore. Në fushën e arsimit, Selia e Shenjte duhet përshëndetur për iniciativën për hapjen e Universitetit "Zoja e Këshillit të Mirë", për edukimin e brezit të ri. Në qytetin e Elbasanit është ngritur një fakultet i mjekësisë për infermierin, diplomat e të cilin njihen nga BE.

Një ndihme të madhe ka dhënë Selia e Shenjte për kurimin falas të të gjithë fëmijëve shqiptare që vuajnë nga sëmundje të rënda dhe atyre vdekjeprurëse. Asistenca dhe konsulenca mjekësore falas për qindra fëmijë, është vlerësuar edhe nga ish Presidenti i Republikës z. Bamir Topi, i cili ka dekoruar disa mjekë të Spitalit "Bambino Gesu", për kontributin e shquar që kanë dhënë në shërimin dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve Shqiptare.

Sot, bashkëpunimi, veprimtarit në mes Selisë së Shenjtë dhe Ambasadës Shqiptare në Vatikan kanë ndryshua, janë intensifikuar në mënyrë të dukshme. Ky ndryshim i dedikohet të Ngarkuarit me punë pranë Ambasadës Shqiptare në Vatikan, z. Visar Zhiti, një personalitet i letrave, një intelektual i shquar dhe krijues i nivelit të lartë në fushën e letërsisë. Ai ka qenë për shumë vite i persekutuar dhe i burgosur për krijimtarinë e tij të

guximshme letrare. Ai është i nderuar dhe i respektuar deri në strukturat më të larta të Vatikanit. Puna këmbëngulëse, sjellja dhe edukata qytetare e vet z. Zhiti dhe të gjithë personelit të përfaqësuesonë diplomatike në Vatikan, na bëjnë të ndihemi mirë. Në qendër të Romës është ngritur kisha katolike për shqiptaret, një ndërmarrje shumë humane dhe tepër domethënëse nga ana e Vatikanit, i cili vlerëson popullin shqiptar.

Vizita e Papa Franceskut në Shqipëri ishte një ngjarje me domethënie të madhe. Papa Francesku i shpalosi Botës shembullin e një kombi të qytetëruar, ku bashkëjetojnë në paqe e harmoni besimtare të pesë besimeve të ndryshme fetare. Vatikanit është gjithmonë pranë popullit Shqiptar. Shugurimi i kardinalit të dytë shqiptar është një tjetër dëshmi domethënëse e vlerësimit dhe vëmendjes së Vatikanit për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Në ceremoninë festive të organizuar

shumë interes dhe tërhoqi vëmendjen e të pranishmeve. Punimet ishin tepër interesante. Në qendër qëndronte portreti i Shën Terezës. Në këtë ekspozitë vend të veçante zinin pikurat e piktorit lezhjan, Gjergj Kola. Punime të një niveli shumë të larte artistik. Piktori, gjithçka i'a kushtonte figurës madhore Shën Tereza. Piktori në fjalë, një njeri modest po duartartë. Ai ka hapur mbi 80 ekspozita, duke filluar nga Greqia, Italia, Spanja, Izraeli, Franca e vende të tjera. Gjergji, prind i dy fëmijëve, Ilirianit dhe Sebastianit, ka edhe një bashkëshortë, që e ka mbështetur shumë në rrugën e bukur të artit të pikturës.

Vizitorët, pasi vizituan dy ekspozitat, ju drejtuan sallës ku do mbaheshin kumtesat. Ambasadori Zhiti, ju uroi mirëseardhjen miqve dhe të ftuarve, pastaj beri një ekspozitë të rrugës 25 vjeçare të marrëdhënies Shqipëri - Selia e Shenjtë, në Vatikan. Në mes të duartrokitjeve, fjalën e merr Prof. Ardian Ndreca, i cili në mënyrë shkencore beri një kronologji të Shqipërisë ndër shekuj. Kumtesa u prit me mjaftë interes nga të pranishmit. Dom Marian Paloka foli me detaje për 38 martiret e kishës Katolike në Shqipëri, të cilët sistemi komunist i Enver Hoxhës i dënoi me pushkatim dhe varje.

Të pranishmit u përshëndeten nga klerikë të Selisë së Shenjte, në Vatikan.

Në mese të duartrokitjeve u lexua përshëndetja, që Presidenti i federatës Nacionale të Shoqatave Shqiptare në Itali (FNAI), gazetari Ndue Lazri dërgonte me rastin e këtij përvjetori të shënuar, në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Vatikanit. Në atë përshëndetje theksohej puna që bën federata dhe shoqatat e saj për integrimin sa më të mirë të emigrantëve shqiptare në jetën italiane, si dhe për mbrojtjen e gjuhës, kulturës, traditave e identitetit kombëtar edhe në toke të huaj. Aty flitej edhe për marrëdhëniet e mira që ka federata me ambasadorin Visar

Zhiti, si personalitet i letrave shqipe.

Përvetonin e 25 -të të marrëdhënies diplomatike Shqipëri - Selia e Shenjte, në Vatikan, e nderuan ambasadorët e vendeve të ndryshme të Botës të akredituar në Vatikan, gazetarë e reporterë, njerëz të artit dhe të kulturës, shqiptarë nga shumë qytete dhe krahina të Italisë.

Një organizim i mrekullueshëm i kësaj ceremonie festive nga poeti, shkrimtari dhe diplomati VISAR ZHITI, me bashkëshorten e tij, zonjën EDLIRA ZHITI.

*Gjin Musa, gazetar,
Vatikan-Romë*



Helmimi sociopsikologjik i fëmijërisë së hershme

BASHKËBISEDIM ME SHKRIMTARIN LEKË IMERAJ -



**Bashkëbisedimi nga Suela Ndoja –
lektore e psikologjisë; Universiteti
“Luigj Gurakuqi”, Shkoder**

Z. Lekë, ju në librat tuaj, vazhdimisht i keni kushtuar një vëmendje të veçantë rëndësisë së fëmijërisë së hershme, si udhërrëfyese për jetën e njeriut të ardhshëm. Parimisht keni theksuar se: Kush dhunohet, do të dhunojë. Të rinjtë e sotshëm, i referohem atyre që janë dhunues, mendoni se janë pasojë e një fëmijërie të helmuar psikologjikisht, me konflikte dhe dhunë?

Unë jam shumë i interesuar për ecurinë e adoleshentëve dhe kjo më shtyn që unë të jem vazhdimisht në kontakt, në forma të ndryshme, me shumë prej tyre, veçanërisht me ata që shfaqin prirje kriminale. Shumica e dhunuesve, që në fëmijërinë e tyre të hershme kanë përjetuar dhunë, nga prindërit, nga njerëzit, nga gjyshërit, nga vëllezëria e rritur, nga më të fortët e klasës dhe rrugës. Një pjesë e tyre, fatkeqësisht nuk dihet numri i saktë, kanë përjetuar edhe dhunë seksuale, deri në përdhunim.

Jam e interesuar të di, ku jeni takuar me këta të rinjtë që shfaqin prirje kriminale? Në mjedise familjare, në mjedise publike? ...

Unë kam qënë dhe jam vazhdimisht në kontakt me të rinjtë të tillë. Unë kam përjetuar jetën e tyre në burgje, kam qënë shpesh i ftuar në shkollë, ndjek rregullisht median mbi ngjarje dhe trauma të fëmijëve, njoh shumë personalisht nga të tillë. Pra, nëse e ndjen dhe e ndjek këtë dhimbje, ajo të çon vetë tek viktima.

Këto trauma që ju përmendët, të përjetuara në fëmijërinë e hershme, e kanë dëmtuar mekanizmin e ndjenjave tek ata?

Natyrisht që mekanizmi i ndjenjave tek ata është i dëmtuar por, kjo nuk do të thotë se ata nuk kanë më ndjenja, por janë krijuar automatikisht “mekanizmat mbrojtës”. Ata komunikojnë keq me të tjerët, ashpër, indiferent, mosbesues. Ndaj ngacmuesve të jashtëm, për gjëra fare të rëndomta ata reagojnë ashpër, me tërbim, urrejtje dhe mosbindje. Ata nuk kanë besim tek askush dhe, madje

urrejnë edhe veten e tyre. Kritika për ata, edhe kur është e butë dhe shumë e arsyeshme, i kalon menjëherë në pozicion mbrojtje. Nga përvoja e hidhur fëmijore, ata e kanë humbur besimin tek të tjerët, por dhe as nuk kanë arritur ta ndërtojnë atë tek vetëvetja.

Më konkretisht: Çfarë ka ndodhur në mekanizmin e ndjenjave të tyre?

Në mekanizmin e tyre të ndjenjave mungon ajo që quhet “busulla e të orientuarit social!” Njeriu, gjetikisht, është i programuar si qenie sociale por, të sjellurit social, mësohet në jetë. Njerëz me një përvojë kaq të hidhur në fëmijërinë e tyre, nuk kanë pasur kurrë rastin që ta mësojnë këtë gjë. Atyre u ka munguar mundësia që të mësojnë besimin, dashurinë, bashkëdhimbjen, bashkëdashurinë, bashkëgëzimin, solidaritetin, humanizmin e të tjera. Ata nuk janë pranuar dhe as dashuruar kurrë, nga askush, ashtu siç kanë qënë. Ata nuk kanë dëgjuar nga askush se “Ti je i vlefshëm dhe i dashur, ashtu siç je, të duam shumë!”; “Ti je i guximshëm dhe i mirë!”; “Të lumtë, e ke bërë shumë mirë!” e të tjera. Tek ata nuk ka arritur të zhvillohet ndjenja e të besuarit tek të tjerët për faktin se të tjerët nuk u kanë besuar kurrë atyre. Ka humbur aftësia e besimit reciprok.

Ky dëmtim kaq i rëndë në mekanizmin e tyre të ndjenjave, është i mundur që të riparohet dhe si, nëse po?

Natyrisht që është i mundshëm të riparohet, nëse jo qind për qind, të paktën në një masë të konsiderueshme, nëse jo të gjithë, shumica janë të mundshëm për t'u rikthyer në jetën sociale normale. Kjo arrihet vetëm me një program të posaçëm të cilin duhet ta ndjekun dhe zbatojnë njerëz profesionistë.

Qëllimi kryesor duhet të jetë që: Të rinjtë problematikë, kandidat për rrugën e kriminit, të shpëtohen nga rruga e kriminit dhe të mos dënohen. Çdo dënim gjyqësor, sado i lehtë që të jetë ai, në fund fare është një pengesë për hapsirat e së ardhmes së tyre. Ne nuk e dimë se çfarë gjenialiteti fshihet tek ata “të paudhë”. Atyre u duhet mësuar mënyra e të reaguarit normal në rastet e ngacmimeve të vogëla. U duhet mësuar se, nga konfliktet e mundshme me të tjerët, dëshimet në shkollë, papunësia, prishja e një lidhje, nuk duhet ta humbin kurajon për jetën dhe se nuk do të braktisen nga të tjerët. U duhet sqaruar se traumat e tyre fëmijore kanë qënë vetëm një pjesë e jetës së tyre dhe jo gjithë jeta dhe se ato janë të mundshme për t'u mjekuar dhe harruar. Mbi të gjitha atyre u duhet mësuar që ta duan dhe pranojnë vetëveten,

ashtu siç janë, se rruga për tek të tjerët fillon nga rruga për tek vetëvetja.

Ju po më thonit: “U duhet sqaruar se traumat e tyre fëmijore kanë qënë vetëm një pjesë e jetës së tyre”. Besoj se ju i



referoheni figurës së psikologut si një figurë që mund të ndihmojë në këtë drejtim apo jo?

Ne vimë nga një regjim ku gjithçka e vendoste politika dhe jo specialisti, jo shkenca. Kështu nuk ecet më. Shoqëria e jonë e desocializuar, nuk mund të socializohet me ideologji dhe urdhëra. Duhet psikologu, madje urgjent, në familje, në shkollë, në punë, shoqëri dhe kudo, ku bashkohen më shumë se dy njerëz bashkë.

Çfarë metode mund të përdoret për t'i rizgjuar një njeriu ndjenjat pozitive, të cilat ai i ka ndrydhur prej kohësh, pra i ka kaluar në gjendje dremitje?

Ndrydhja e ndjenjave tek njeriu vjen gjithmonë nga faktorë traumatikë të jashtëm. Nga faktorë të tillë, tek njeriu, krijohet “bllokuesi social”. Ky bllokues nuk mendohet i përhershëm. Gjëja e parë që duhet bërë është, ndarja e viktimës me dhunuesët dhe vendosja e tij në një mjedis paqësor dhe të besueshëm. Me këtë nuk duhet menduar se u zgjidh gjithçka. Kohëzgjatja e efektit të traumave tek individët është e ndryshme. Duhet që nga specialistët të hartohet dhe zbatohet me korrektesinë më të madhe “programi i kundër helmimit psikik dhe shpirtëror”.

Pra, tek mekanizmi i ndjenjave të fëmijës së traumatizuar, krijohet një diferencë e madhe midis ndjenjave pozitive dhe atyre negative. Si mund të shpjegohet kjo diferencë?

E para, dua të theksoj se ndjenjat nuk klasifikohen në negative dhe pozitive, sepse nuk janë të tilla. Ndjenjat

janë ndjenja. Njeriu nuk është i pajisur nga natyra me ndjenja të tepërta dhe as të dëmshme. Kur ndjenjat kalojnë masën pra, dalin jashtë kontrollit, të gjitha bëhen të dëmshme, madje dhe të rrezikshme. Edhe ndjenja e dashurisë kur del jashtë kontrollit mund ta çojë njeriun deri në vetëvrasje. Me anë të një terapie intensive, shumë të specializuar dhe që zbatohet nga njerëz të kualifikuar, mund të arrihet që viktima, madje shumë shpejt, të fillojë të mendojë për të kaluarën e vet të dhunshme. Ai fillon të mendojë shkaqet që e çuan në rrugën e dhunës. Krimi nuk është kurrë fillimi i rrugës kriminale por, pikërisht një zhvillim i gjatë. Pikërisht këtë zhvillim të gjatë duhet të kuptojë viktima dhe nëse nuk arrin që ta kuptojë vet, i duhet bërë e qartë. Nëse ai arrin ta kuptojë vetë këtë, duhet menduar se ka arritur shumë.

Të gjitha këto që thatë ju, në themel tregojnë për një vetëdije të munguar apo të kufizuar tek fëmijët. Cilët janë faktorët kryesorë që e kushtëzojnë zhvillimin e vetëdijes tek fëmijët?

Është e drejtë ajo që thatë. Në raste të tilla kemi të bëjmë me një vetëdije të pazhvilluar dhe me një njeri “kopje” e dikujt (nuk i dihet se e kujt), aspak origjinal. Faktorët janë të shumtë, por unë do të theksoj pesë më kryesorët: Edukimi i ndrydhur, seksualiteti i heshtur, mjedisi i helmuar, bllokimi i iniciativës, frika nga marrëdhënjet me të tjerët.

Sado që flitet për rrezikun e edukimit autoritar, pra, edukimit të ndrydhur, duket se nuk kuptohet, as nga prindët, as nga mësuesët dhe nga askush. Këtij rreziku nuk i shpëton dot askush. Thuajse të gjithë të rriturit, pavarësisht nga lidhja dhe funksioni që kanë me fëmijët, janë më të gatshëm t'i qortojnë dhe ndëshkojnë ata se sa t'i lavdërojnë. Kështu fëmijët mund të mendohen “lule nën gur”. Dhe kjo nuk kalon pa gjurmë në shpirtin e fëmijës. Të rriturit nuk e kuptojnë se një mënyrë e tillë e të edukuarit dëmtton rëndë vetëdijen e fëmijës.

Ju përmendët më lart “seksualitetin e heshtur”. Çfarë pasojash mund të sjell tek të rinjtë heshtja seksuale dhe sa duhet të dinë ata për një gjë të tillë?

Të rinjtë e sotshëm po priren gjithnjë e më shumë nga tendenca e lidhjeve ndërgjinore çka sjell kontaktet seksuale të dëshëruara ose jo. Skenaret e seksit, fëmijët, gjithnjë e më fëmi, i kanë në kokë. Një gjë të tillë në nuk e ndalim dot. Kontakti me botën pornografike është shumë i madh. Ka dhe një problem tjetër madhor që i shtyn fëmijët drejt seksit të parakohshëm dhe të pakontrolluar. Është seksi si mallë, si drogë, si kom- ▶

Migjeni im

Sot Migjeni ka datëlindjen. Njëqind e pesë vjet më parë ai erdhi në jetë si çdo njeri tjetër, i thjeshtë e i zakonshëm, për të ikur në moshën njëzet e shtatë vjeçare si një fenomen letrar që la gjurmët e veta, të cilat nuk mund të zhbëhen kurrë prej letërsisë shqiptare. E gjithë krijimtaria e tij, qëndron sot si një gur kilometrik, si një drejtim që na tregon udhën drejt letërsisë dhe artit të vërtetë.

Dashuria ime për letërsinë e Migjenit ka nisur qysh herët, ende pa e ditur se me të ndanim të njëjtën datë lindjeje, atëherë kur isha një lexuesi thjeshtë dhe nuk e dija se çfarë profesioni do të zgjidhja në jetë. Qysh atëherë, Migjeni ka qenë shkrimtari im dhe i tillë mbetet edhe sot. Krijimtaria e Migjenit është ura që më shtyu të eksploroj në gegërisht dhe ta dua atë, është shtyja që më bëri të ndjej të afërt dhe të dua Shkodrën dhe shkoderanët, pikënisja për të eksploruar në artin e madh të fjalës.

E dua letërsinë e Migjenit për fjalën, për mendimin, shqetësimin, dashurinë dhe revoltën që përçon. Ai është rebel, tipik shkrimtar i vërtetë, shpirtvibrues dhe i pakompromis. Si poezia, ashtu edhe proza e tij, i përkasin një shkalle mjaft të lartë artistike, një letërsie që të godet dhe të bën të mendohesh thellë. Migjeni është një shkrimtar i pakohë, udhëton vazhdimisht duke mbetur përherë aktual. Ai nuk i imponohet askujt me artin e tij. Migjeni flet thjeshtë dhe pa dashur të thithë mbi vete vëmendjen e të tjerëve tërhiqet në vorbullën e tij.

Migjeni ka mjaft ndjekës dhe adhures,

por mbi të gjitha ka shumë studiues dhe shkrimtar që janë marrë me veprën e tij. Natyrisht, një fenomen letrar si ai nuk mund të përjashtohet. Ai do të mbetet gjithnjë në fokus të atyre që e duan dhe jetojnë me letërsinë. Nga i gjithë ky fond kustuar atij, gjithnjë kam nxjerrë si të veçantë veprën "Migjeni", të profesorit tim të ndjerë Rinush Idrizi. Është analiza më e plotë që është bërë shkruar ndonjëherë për Migjenin, një studim që mbetet gur i rëndësishëm në fushën e studimeve letrare shqiptare.

Por Migjeni nuk ka vetëm simpatizantë dhe adhurues. Nëpër kohë, krijimtaria e tij, herë me dashje e herë jo, është keqinterpretuar, anatemuar, përbuzur, shpërfillur. Dhe kjo sepse kanë hyrë në mes zhvillimet politike, duke pasur si qëllim në të njëjtën kohë edhe tërheqjen e vëmendjes si "faktor të jetës letrare shqiptare". Veçmas në këtë çerek shekullin e fundit, Migjenin e kanë quajtur "komunist", "revolucionar", e plot të tjera. Duke anatemuar Migjenin, është synuar të ngrihet e të vihet në pedestalin e tij Fish-ta, Koliqi, etj. Por Migjeni është Migjeni dhe ai qëndron në letërsinë shqiptare në vendin e tij, pa dashur që të hedhë hije e të eklipsojë askënd. Ai është fenomeni më tipik i letërsisë moderne shqiptare, asaj letërsie që i kushtohet Njeriut.

Sot Migjeni ka datëlindjen. Ka njëqind e pesë vjet që ka ardhur, po qëndron dhe do të jetojë gjithnjë, ky fenomen letrar i papërsëritshëm.

Nga Kliton Nesturi



si qetësues dhe vlerë njerëzore, si ngushëllim për shpirtërat e humbur. Pjekuria fizike është aty por, jo vetëdija, jo llogjika. Pastaj shpirti plagoset dhe dhimbja e kësaj plage mund ta ndjekë fëmijnë për një periudhë të gjatë të jetës së vet. E vetmja rrugë e sigurt shpëtimi është të folurit hapur me fëmijët për seksin dhe problemet seksuale. Kjo duhet bërë në familje dhe shkollë. Një fëmijë seksualisht i ditur, është në masën më të madhe të mundëshme i garantuar nga rreziku seksual. Ai nuk vrapon pas pornove dhe joshjeve të gabuara seksuale. Kurrësesi nuk duhet të mendojmë që të thajmë detin por, t'u mësojmë fëmijëve notin. Deti nuk thahet, noti mësohet, gjithkush e mëson. Duhet thyer me çdo kusht, menjëherë dhe sa më parë tabuja seksuale. Ndryshe nuk bëhet.

Si i mendoni marrëdhëniet e sotshme mësues-nxënës?

Për këtë vihen re dy anët e medaljes: Nga njëra anë, këto marrëdhënie janë dëmtuar, mungon respekti dhe besimi reciprok. Nga ana tjetër janë bërë më të lirshme. Në këtë situatë duhet që personaliteti i mësuesit të jetë më i qëndrueshëm. Ka mësues që nuk i mendo-

jnë fëmijet subjekt, i mendojnë fëmijë dhe i trajtojnë si të tillë. Shumë mësues duket sikur janë të lodhur shumë, madje nuk e dashurojnë më profesionin e tyre. Mendoj se mësues të tillë kanë probleme me vetëveten. Atyre u mungon aftësia e të përshtaturit me të renë, ata nuk janë në gjendje të diferencojnë fëmijët e sotshëm me ata të djeshmit. Dhe më keq akoma, mësuesët nuk bëjnë përpjekje për vetëkualifikimin e tyre. Është tragjike por, unë njoh shumë mësues dhe mësuese të cilët nuk kanë biblioteka personale në shtëpi, madje asnjë lloj libri, me përjashtim të atyre mësimit.

Si e mendoni rolin e familjes së sotshme në lidhje me aftësitë edukuese të fëmijëve?

Ky rol duket se është dobësuar shumë. Familja klasike, me të dy prindët, po zvogëlohet gjithnjë e më shumë, kështu që barra e rëndë e edukimit ka mbetur në njërin apo tjetrën dorë. Po përjetojnë konflikte të mëdha dhe vështirë se ka një vesh të hapur, në familje, për ndjenjat dhe interesat e fëmive. Kontaktet sociale brenda familjes kufizohen gjithnjë e më shumë. Mungon mjedisi, koha dhe mundësitë ekonomike që fëmijët të mund të përjetojnë diçka të këndshme,

jashtë mureve të shtëpisë, bashkë me prindët e tyre. Ata e vuajnë shumë diferencën me bashkëmoshatarët e tyre të klasës apo lagjes.

Një problem tjetër madhor është niveli i ulët kulturor i shumë familjeve, sidomos të atyre që kanë zbritur nga zonat malore në qytet. Integrimi i tyre dhe i fëmijëve të tyre me jetën dhe kulturën e qytetit është shumë i vështirë, madje mund të mendohet edhe i pamundur. Nëse arrihet përshatja, duhet menduar sukses i madh.

Sot vihet re kudo të qënë të një gjeneratë të rriturish, të cilët, me sa duket kanë pësuar një dëmtim të rëndë në mekanizmin e ndjenjave të tyre, duke krijuar kështu një mjedis social me ndotje të madhe psikike dhe një shpirt të helmuar. Çfarë mund të bëjë shkolla për ta mënjeluar këtë rrezik tek fëmijët?

Ky problem është botërisht i njohur. Në Amerikë dhe shumë vende të tjera, janë krijuar shkolla të veçanta, me programe të veçanta për të zbutur rrezikun e kësaj dukurie. Në sistemin tonë arsimor duhet të ndryshojë diçka dhe madje shpejt. Sot, në kushtet e një ndotje të madhe të strukturave sociale, nuk duhet të bëhet fjalë vetëm për dhënie diturish në shkolla por, njëkohësisht dhe me shumë përparësi u

duhet mësuar fëmive arti i komunikimit dhe aftësia për zgjidhjen e konflikteve. Marrëdhënjet me të tjerët janë po aq të rëndësishme sa dhe nota e mirë në lëndët mësimore. Fëmijët nuk i izolojmë dot nga mjedisi social helmues por, duke i "vaksinuar" në shkollë, do të ulim në një përqindje të madhe rrezikun e helmimit nga ky mjedis. Ky nuk është problem që zgjidhet nga mësuesit, sado të ndërgjegjshëm dhe të aftë që mund të jenë ata. Një gjë të tillë duhet ta zgjidhë shteti. Kjo nuk duhet menduar se vetë mësuesët nuk duhet të bëjnë asgjë. Një mësues i aftë dhe i vetëdijshëm gjithmonë e gjenë kohën dhe mënyrën për të depërtuar në shpirtin e lënduar të një nxënësi.

Së fundmi, ju lutem cili është mesazhi për lexuesit?

Mesazhi im është ky: Mos i dhunoni fëmijët! Mos i ideologjizoni ata! Mos e ndyni psikikën e tyre dhe mos e helmoni shpirtin e tyre! Dhimbja e tyre jemi ne, e ardhmja e tyre jemi ne dhe ata janë e ardhmja e kombit, jo ne.

Ju falënderoj përbashkësisht për mjaft interesant dhe të dobishëm për punën që duhet bërë me fëmijët tane, që duhet të bëjmë për të ardhmen e fëmijëve tanë!

Njeriu që nuk ka nevojë për një orë me zile; idetë e tija të mbajnë zgjuar gjithmonë

ME RASTIN E 85 VJETORIT TË LINDJES SË MJESHTRIT TË MADH, FADIL KRAJA -

Më 10 tetor 2016, në mjedisin e bibliotekës "Marin Barleti", në orën 18.00, Shoqata e Shkrimtarëve të Shkodrës në bashkëpunim me Bibliotekën "Marin Barleti", organizuan një veprimtari letrare në kuadrin e 85 vjetorit të datëlindjes dhe 60 vjetorit të krijimtarisë së Mjeshtrit të Madh, Fadil Kraja.

Në këtë ceremoni u mbledhën figura të larta të qytetit tonë, aktorë të teatrit dhe estradës së Shkodrës, studiues, shkrimtarë, bashkëpunëtorë, aktivistë e më gjerë nga bashkësia, të cilët e vlerësojnë Fadil Krajen si njërin prej dramaturgëve më të mirë të Shqipërisë.

Ceremoninë e hapi, drejtori i Bibliotekës "Marin Barleti", Gjovalin Çuni. Më pas, e mori fjalën kryetari i Shoqatës së Shkrimtarëve në Shkodër, poeti i mirënjohur Skender Temali. Fjalën e mori Ermira Ymeri, e cila u ndal kryesisht në rolin e femrës në veprat e ndritura të Fadil Krajes. Pastaj folën Isa Alibali, ish drejtori i Teatrit "Migjeni", poetja Fatime Kulli; Dimitrov Popovic, poeti Gjovalin Luma nga Vermoshi, që banon në Miçigan të SHBA, Kadri Fikaj, Drejtoresha e Teatrit "Migjeni", aktorja Rita Gjeka, e të tjerë. Në mes të folësve pati recitime, nga aktorja Drane Xhaj, aktori Agron Dizdari, Rajmonda Marku dhe një interpretim nga Merita Smaja dhe gjithashtu një recitim i një poezie të krijuar vetë, nga Humoristi Qazim Çela.

Në mes të këtyre recitimeve e opinionëve, rapsodi Jonuz Delaj me lahutë, prej Nikçit të Kelmendit, këndoj disa

vargje me lahutë, të krijuar enkas për Fadil Krajen.

Mund të përmendim disa nga fjalët e shprehura nga përkthyesi Zija Vukaj, i cili theksoi: "Fadil Kraja, një krijues i përmasave të tilla formon një stacion të pashmangshëm dhe ka një aureolë mad-

se në kulturën tonë, kam vendosur një guralec sado të vogël, e ndjej veten të lumtur, e ndjej veten krenar ...!"

Lidhur me këtë na lejohet të argumentojmë se sa më thellë që të duam të themi për Fadil Kraja apo t'u hyjmë pyetjeve, aq më interesante dhe më të thella bëhen

gjithmonë aq sa edhe të na mbajnë në sot dhe brezat që do pasojnë.

Për ta përmblytur me një thënie të Albert Camus, gazetarit, dramaturgut, novelisti, filozofit dhe të laureuarit me çmimin Nobel: "Synimi i një shkrimtari është për ta frenuar civilizimin nga shkatërrimi i vetes", shprehim bindshëm se Mjeshtri i Madh ka punuar aq shumë për ta vënë në jetë shkrimet e tija sa të arrijë jo vetëm të shohë vlerësimin e rrallë të shtrirë rreth e rrotull tij nga aq miq, shokë, dashamirës, artdashës, intelektualë, studiues e më gjerë nga fusha të ndryshme jetësore, por edhe ti gëzohet faktit që të gjithë kemi patur shansin të marrim prej mesimeve të tija për të përmirësuar sa më shumë që mundemi veten dhe të vazhdojmë të avancojmë.

Së fundmi: I urojmë përzemërsisht Anëtarit të Nderit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe Mjeshtrit të Madh të letërsisë shqiptare, të ketë jetë të gjatë, të gëzojë shëndet, dhe të vazhdojë të qëndrojë zgjuar për të na ndriçuar me idetë e tija brilante!

I kujtojmë se, datëlindja është një herë në vit, por miqësia jonë është e veçantë dhe plot kuptim çdo ditë. Prandaj në datëlindjen tënde të gjithë të pranishmit, por me siguri themi edhe ata që nuk patën mundësi të jenë aty, dëshiruan që Mjeshtri i Madh të jetë i lumtur dhe bënë diçka të veçantë për ti treguar sesa shumë e vlerësojmë dhe e duam!

Përgatitur nga **Ndue Sanaj**
e **Suela Ndoja**



hështie qoftë për larminë e veprës qoftë për larminë e tematikave. Ai qëndron hijshëm në panteonin e letërsisë shqiptare por edhe të gjithë autorëve të veriu!"

Në fund foli dhe Fadil Kraja, që në mes të tjerave tha: "Po citoj Sokratin: Në qoftë

pyetjet. Dhe mendojmë se bëhet fjalë për një punë arti i cili nuk mund të huazohet, por rrjedh thellë në venat e gjakut, të mendjes dhe shpirtit të një personi, që nuk ka patur nevojë për një orë me zile, pasi idetë e tija e kanë mbajtur zgjuar

Një ditë e bukur për nga kënaqësia, historia, rëndësia dhe vlera ...

- VIZITË RRËSHENIT -

Aty ku flet tradita, mikpritja nuk mungon- mikut i dilet përpara në shenjë respekti, aty e kuptova momentin e takimit kur zotërinjtë Gjergj Marku e Fran Preçi kishin dalë ku ndahet rruga për Rrëshen, për respekt e bujari dhe nga aty ne ishim në besën e traditës së Mirditës. Secili që na takonte me plot gaz e bujari. Në këtë rast dua ta përmend bujarinë e një djali bujar punëtor e biznesmen që e la Italinë për të investuar në bjeshkët e Mirditës. Një restorant veror të bukur natyral në mes pishave dhe bukurive të Mirditës, aty gjetëm një mikpritje "bukë e krip e zemër", sipas traditës ai, ishte tani edhe miku im, Bujari.

Qëllimi i vizitës

Shoqata e Vëllazërimit Kosove - Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" me qendër në Pejë lidh marrëveshje bashkëpunimi me Ansamblin folklorik "Mirdita" në Rrëshen. Përfaqësues nga pala e Shoqatës në Pejë, ishin Ukshin Jashari - Kryetari i saj dhe Frasher Racaj - sekretari i Shoqa-

tës; nga Istogu, Nuradin Imeraj dhe Zeqir Mehmetaj (Radio Fontana); ndërsa nga Mirdita ishte Drejtori i Shtëpisë së Kulturës së Bashkës së Mirditës, me qendër në qytetin Rrëshen, Gjergj Marku; Presidenti i Ansamblit "Mirëdita", Fran Preçi dhe studiuesi e historiani, Gjon Marku. Nga Shkodra merrte pjesë Ndue Sanaj-Kryetari i Shoqatës atdhetare "Dukagjini" dhe anëtar i redaksisë së gazetës "Dukagjini", Lulash Brigja.

Merita i takon drejtorit të Shtëpisë së kulturës "MIRDITA", i cili gjatë gjithë kohës nuk përtoi të na njoh për së afërmi me traditën dhe kulturën e Mirditës. E përgëzojmë dhe i gëzohemi faktit për punën e madhe që zhvillon dhe pasuron në kulturën mbarëkombëtare, njeri institucional e energjik që i duhet kombit e shtetit.

Ndue Sanaj, na thotë: Një takim mbresëlënës në Rrëshen! Një takim në mes përfaqësuesve të Shoqatës "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë, të Shoqa-

tës Atdhetare "Dukagjini" dhe të Shoqatës të Ansamblit "Mirdita" të përfaqësuar nga Gjergj Marku e Fran Preçi. Ne mes shoqatave u nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, Një takim, që nuk ka për tu harruar kurrë, në veçanti nga drejtori Gjergj Marku, i cili na njohu me punën e jashtëzakonshme që është bërë e vijon të bëhet në njohjen e lënien trashëgim të kulturës popullore të zonës së Mirditës.

Ju lumtë!

Ukshin Jashari, na thote: Ishte një takim i suksesshëm, i falënderojë shume, shume Gjon Markun, Fran Preçin e Gjon Markun dhe Ermal Duken për pritje vëllazërore, por nuk mundem pa i falënderua edhe Ndue Sanaj, Lulash Brigjen, Zeqir Mehmetajn dhe Nuredin Imerajn, që ishin me ne, në këtë takim, në qendrën e Mirdite, në Rrëshen.

Ju faleminderit Mirdita!

Nuredin Imeraj



Gjatë vizitës në Muzeun Etnografik të Rrëshenit



Në momentin, që në trevesën tradicionale, gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes Shoqatës "Martin Dreshaj" dhe Shoqatës së Ansamblit "Mirëdita", Gjergj Marku dhe Ukshin Jashari

Një Premtim i Përmbushur!

KRONIKE MBI LIBRIN "PREMTIN I PËRMBUSHUR", TË AUTORIT GJON SINISHTA

Më datë 10 Tetor 2016, ora 18. 30, në Sallën "Kardinal Mikel Koliqi", në kuadër të veprimtarive për Kanonizimin e Martirëve të Kishës Katolike në Shqipëri, Komisioni "Drejtësi dhe Paqë Shqipërisë" zhvilloi promovimin e librit "Premtimi i Përmbushur" të autorit Gjon Sinishta, përkthyer nga gjuha angleze nga Vladimi Banushi dhe mbështetur nga Organizata Katolike RENOVABIS-Freising, në Gjermani.

Të pranishëm ishin Arqipeshkvi, Mons. Angjelo Massafra, përfaqësues të Familisë së Shën Shtjefnit dhe të famullive të tjera, përfaqësues të Komisionit "Drejtësi dhe Paqë" të kryesuar nga Kryetari z. Luigj Mila, përfaqësues të Radio Marisë, përfaqësues të Shoqatës "Projekti Shpresa", përfaqësues të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", përfaqësues të Grupit "Iliricum" të Kishës Françeskane e të tjerë, nga komuniteti dhe më gjerë.

Promovimi i librit u drejtua nga Znj. Marinela Buxha, anëtare Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe u hap me kumtesën e redaktorit të librit Lisandër Kola; Studiues, Pedagog në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës, i cili solli një përmbledhje të martirëve tanë në kujtimet e disa personaliteteve të shquara në veprën e Gjon Sinishtës.

Në vijim, nxënës të shkollës "Pjetër Meshkalla" interpretuan pjesë nga vepra, fq. 143, pikërisht "Kanga e ndalueme" të Kardinalit Ernest Koliqi.

Kumtesa vijuese u fokusua mbi vlerat artistike dhe letrare të veprës "Premtimi i Përmbushur", e cila i sollën nga Arben Prendi-Pedagog në Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Pas kësaj kumtese, një nxënës e shkollës "Pjetër Meshkalla" interpretoi pjesë të veprës.

Prezantimi i figurës së autorit Sinishta nisur nga përshypje vetjake nga takimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, u soll natyrshëm nga Angjelin Deda: Studiues i Historisë së Klerit Katolik në Shqipëri; konsulent për faktet e sipërpërmendura në veprën.

Sërish, nxënës të shkollës "Pjetër Meshkalla" interpretuan pjesë të veprës.

Kumtesa përmblylëse e promovimit të librit u prezantua nga Gjovalin Çuni-Drejtor i Bibliotekës "Marin Barleti", Shkoder, i cili ligjëroi mbi kontributin e botimit të parë të veprës "Premtimi i Përmbushur" si dëshmi e perspektivës dhe rezistencës së



martirëve të Kishës Katolike në Shqipëri.

Fjala përshëndetëse nga Mons. Angjelo Massafra, i cili ndër të tjera theksoi: "Të vërtetës mund ti bësh shumë gjëra. Mund t'a manipulosh, mund ta varrosësh nën tonelata gënjeshtresh, mund t'a sjel-

lësh të cunuar në funksion të interesave të caktuara e të tjera. E megjithatë, e vërteta nuk "trembet" nga të gjitha këto, sepse në të gjitha rastet, pavarësisht sa kohë kalon, ajo del në sipërfaqe. Vetëm nga tri gjëra "trembet" e vërteta: in-

torimi, shtrembërimi dhe harresa. "Çfarë mund të themi për të vërtetat e persekutimit të feve dhe të besimit katolik, në veçanti, nga diktatura komuniste në Shqipëri? Ata e shpallën dhe e dokumentuan me një krenari perverse deri në detajet më të imëta."

Gjithashtu ndër të tjera u drejtohet lexuesve: "Vepra, që ju paraqesim, është një përmbledhje e dokumentuar e historisë së qëndresës dhe heroizmit të klerikëve tanë nën thundrën komuniste. E veçanësisht e saj është se u shkrua në Amerikë në kohën kur në Shqipëri, murtaja ateiste bënte kërdinë. U shkrua nga Gjon Sinishta, ish student i seminarit, i cili pati fatin të shpëtonte duke u arratisur nga Shqipëria komuniste drejt Jugosllavisë, për tu vendosur në Amerikë"

Në mbyllje të kësaj kronike, të dashur lexues, theksojmë që autori e ka ideuar këtë libër një natë të ftohtë Marsi, në vitin 1946; ajo që ka dashur të përçojë është se i ka bërë një premtim vetes, se nëse një ditë, me ndihmën e Zotit do të hidhej në botën e lirë, do të rrëfejë historinë e vuajtjeve që kanë kaluar: premtimi që më në fund ka arritur të përmbushë, e ka mbajtur gjallë gjatë gjithë tridhjetë viteve me plot vështirësi, përfshirë edhe burgun, edhe monotinë e pafund në kampet e refugjatëve.

Gjithashtu theksojmë, se autori ia kushton këtë libër numrit të madh të klerikëve katolikë shqiptarë, që zgjodhën të jepnin jetën sesa të hiqnin dorë nga idealet e besimit, drejtësisë dhe lirisë. Falë guximit dhe dashurisë së tyre, ata u bënë heronj madje edhe martirë të këtij shekulli. Ashtu sikur edhe autori, nënvizojmë me shpresë që historia e mundimeve të kontribuojë për më shumë tolerancë dhe mirëkuptim mes të gjithë popujve.

Përgatitur nga **Suela Ndoja**

Mirënjohje dhe respekt për Zef Gjeloshin "Metushin"

Para pak kohe e u nda nga jeta nga një sëmundje e rende Zef Gjeloshi. Zefi lindi në fshatin Abat të krahinës së Shalës, në vitin 1932, në një familje me tradita të larta patriotike, të besës e bujarisë. Mësimet e para i mori në shkollën e fshatit të tij të lindjes Abat, por dhe në dhomën e burrave pranë trevesës me miq, ku urtia, fjala e burrave u nguliten në mendjen e Zefit që në fëmijërinë e tij të hershme.

Duke u rritur me frymën e patriotizmit, dashurisë për lirinë e atdheut, Zefi që i ri mori pjesë në LANÇ, në fillim në çetën Partizane të Dukagjinit, si korrier i saj dhe më vonë në batalionin partizan "Perlat Rexhep" të Shkodrës, duke u cilësuar për qëndresë dhe trimëri derisa u çlirua Shq-

ipëria.

Me çlirimin e vendit Zefi u aktivizua me organizatën e rinisë, duke qenë veprimtar dhe organizator shembullor i saj. Ai mori pjesë në aksionet e para për rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta. Zefi që ndër të parët të rinj, që mori pjesë në aksionet e rinisë, për ndërtimin e hekurudhës Tirane - Durrës, Durrës - Kavaje, rrugës Kukës - Peshkopi e të tjera.

Në vitin 1952 - 1954, Zefi kreu shkollën e bashkuar të oficerëve, duke filluar kështu shërbimin si oficer karriere në ushtri. Në vitin 1955, kaloi në strukturat e mbrojtjes së kufirit shtetëror, ku shërbeu në detyra të ndryshme si: Komisar poste dhe batalioni në Theth të Dukagjinit, Velipojë të Shkodrës, Kelmend të Malësisë së Madhe, Shëngjin të Lezhës, Patok të Kurbinit e të tjera vende.

Gjate kësaj periudhe kreu edhe shkollën e MPB për kufirin si dhe shkollën e lartë të PPSH, me përfundime të kënaqshme. Për merita, përkushtim dhe rezultate të larta në kryerjen e detyrave të ngarkuara, Zefi është dekoruar me urdhra dhe medalje të ndryshme nga Presidiumi i Kuvendit të Shqipërisë. Ka dalë në pension, me gradën major.



Me daljen në pension u bë pjesëtar shume aktiv dhe kontribuues në rritjen dhe forcimin e organizatës së veteranëve të LANÇ, si mbartëse dhe trashëguese i vlerave të larta të LANÇ.

Një kontribut të rëndësishëm, Zef Gjeloshi ka dhënë në punët dhe veprimtaritë që ka zhvilluar dega e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", për Tiranën. Ai ka qenë anëtar i grupit nismëtar për krijimin e kësaj degë dhe në vijimësi ka qenë anëtar i kryesisë, deri sa u nda nga kjo jetë. Kontributi i tij në forcimin, zgjerimin

min, bashkëpunimin, rritjen e vlerave të Dukagjinit dhe të dukagjinave në Tirane e më gjerë, që i përhershëm dhe me plot dëshirë e pasion. Bashkëpunonte, këshillonte dhe vepronte me maturi, duke shfrytëzuar përvojën e gjatë të punës, urtësinë e trashëguar nga vendlindja, këmbënguljen e një ushtaraku të devotshëm, cilësi këto që e bene Zefin të nderuar e të respektuar jo vetëm në degën e shoqatës tone, por edhe në bashkësinë ku jetonte, në çdo mjedis shoqëror, ai ka qenë shembull me punën dhe prezencën e tij.

Ndarja nga jeta e Zefit ia në pikëllim familjen, të afërmit dhe shokët e tij. Ai është përcjell për në banesën e fundit me nderime nga familjaret, miqtë dhe shoke të shumtë, që jetojnë e punojnë në Itali, sepse edhe vete Zefi shumicën e familjarëve të tij i kishte në Itali, ku dhe ndërroi jete. I përjetshëm qoftë kujtimi i Zef Gjeloshit! I lehtë dheu!

Zef Bari, Nikoll Martini, Prek Kosuri

BIRI I KELMENDI

**NJË TAKIM ME SHKRIMTARIN DHE PUBLICISTIN E SHQUAR
RUSH DRAGU NË MICHIGAN**

Para pak ditësh, gjatë një vizite në SHBA, takova një shqiptar, një burrë të ditur, intelektual, njohës i historisë dhe kulturës shqiptare, bir i Kelmendit të Malësisë së Madhe që me punën e tij dhe veprën e tij kishte krijuar një respekt dhe reputacin të madh në gjithë Diasporën shqiptare në Amerikë.

Rush Dragu, kështu quhet ky personalitet, që unë pata fatin ta njoh, të provoj mikëpritjen e tij, të shoh nga afër punën e bukur dhe të palodhur që bënte, por edhe të bashkëbisedoj gjatë për tema të ndryshme dhe gjithë kjo më ngacmoj të shkruaj diçka të trajtuar jo si një reportazh, por si një portret të një intelektualit që të imponon respekt.

Gjatë bisedave ai më tregoi shumë për punën e tij në Amerikë, por unë pas këmbënguljeve të mia mësova shumë gjëra edhe për të kaluarën e tij, shkollimin dhe veprimtarinë e tij që në moshë të re në vendlindje, Kelmend të Malësisë së Madhe, sepse edhe e kaluara e tij në Shqipëri, ashtu si jeta e çdo shqiptari të brezit të tij, apo më të vjetër kishte dritëhijet e veta.

Nga viti 2002 Rush Dragu me familjen e tij, lë atdheun dhe vendoset në Amerikë, ku unë pata rastin ta njoh nga afër dhe të informohesha në bisedat me te se kush ishte, nga vinte dhe ç'rol luante në Michigan, Detroit, qyteti ku banonte dhe vepronte.

Rush Dragu ka lindur në një vend me një natyrë dhe histori madhështore, në Kelmend të Malësisë së Madhe. Aty është rritur dhe edukuar, aty është shkolluar si gjithë fëmijët e tjerë, deri sa ka mbaruar shkollën 8-veçare me ëndrrat dhe dëshirat e tia feminare, për t'u bërë nesër një mësues i mirë për fëmijët e Malësisë.

Por jo gjithmonë, për arsye të ndryshme ëndrrat realizohen. Këtij djaloshi të ri i'u këputen në mes, pasi si për shumë të tjerë vendoste biografia e familjes. Kështu që nuk arriti të vazhdojë këtë shkollë, i'u dha e drejta të vazhdojë Shkollën Veterinare në Shkodër. Rushi shkon në këtë shkollë me një dëftesë me rezultate të shkëlqyera, të cilat i ruajti edhe gjatë atyre katër viteve. Ai gjeti atje shokë të rinj nga rrethet e ndryshme të vendit dhe

jeten e bënë në këtë shkollë më të bukur nga pasioni i madh që kishte, jo vetëm për mësimet, por edhe për gjitha aktivitetet kulturore, artistike e sportive, rimore e festive, pjesë e të cilave u bë edhe ai vetë.



Pasioni tij ishte letërsia dhe gazetaria, kështu që shpejt u angazhua në qytetin e Shkodrës në Klubin e Rinisë "Heronjtë e Vigut", ku mori edhe çmime për krijimtari letrare, por edhe me botime të herë pas herë në gazetën lokale "Jeta e re" me artikuj dhe reportazhe nga jeta në shkollë, por më vonë edhe nga jeta dhe aktivitetet në Kelmend.

Shkollën e mesme e mbaroi me rezultate të larta, notë mesatare 10-të, por përsëri në asnjë nga degët që dëshironte të vazhdoje studimet e larta nuk i'u hap drita jeshile.

Gjithsesi, i'u pranua e drejta të vazhdojë studimet për agronomi në Institutin e Lartë Bujqësor në Tiranë, të cilin e mbaroi në vitin 1985 me rezultate të shkëlqyera dhe u emrua agronom sektori në një nga fshatrat e Kelmendit.

Çdo herë në jetë gjëndet një njeri i mirë. Pikrisht një ish Kryetar i Keshillit të Bashkuar Kelmend, mbase edhe nuk merr shumë parasysh gjyshin e Rushit të pushkatuar në janar të vitit 1945 dhe ngulë këmbë të emrohet mësues specialist në Shkollën e Mesme të Bashkuar Tamarë. Kjo i përket vitit 1987 dhe nga ai vit Rush Dragu do të vazhdojë e përfundojë studimet për Bio-Kimi.

Ndërkohë në vitin 1992, kohë kur punonte mësues e më vonë drejtor i Shkollës së Mesme në Tamarë, është një ndër themeluesit e degës së Partisë Demokratike të Malësisë së Madhe e më vonë anëtar i kryesisë së keshillit të rrethit.

Në vitin 1996 është zgjedhur kryetar i Komunës Kelmend, kontribut të cilin e vazhdon deri në vitin 2000, duke përballuar situatat e vështira e kaotike të viteve '97-'98 e duke mbrojtur së bashku me komunitetin çdo institucion pa u djegur, vjedhur apo dëmtuar. Gjatë këtij mandati ai pati shumë suksese në dobi të komunitetit.

Në vitin 2002, ai së bashku me familjen e tij vjen në Amerikë, ku do të fillojë një jetë të re, të cilën me aftësitë e tij nuk e quan të pamundur. Ai integrohet menjëherë, së pari në New York dhe pastaj në shtetin e Michiganit, ku shkolla dhe studimet që ka bërë, eksperiencia e të kaluarës si drejtues dhe organizator, por në mënyrë të veçantë pasioni për letërsinë, artin e kulturën e bëjnë që shpejt të bëhet një ndër shqiptarët më të shquar në mes të bashkëatdhetarëve.

Unë e gjeta Rush Dragun në studion e ACTV, televizionit të Komunitetit të shqiptarëve në Michigan si gazetar të palodhur që me shkrimet dhe informacionet e tia jepte një kontribut të shquar për pasqyrimin e jetës sociale, kulturore, ekonomike e politike në gjithë Diasporën shqiptare në Amerikë.

Këtë e pashë me sytë e mi gjatë organizimit dhe zhvillimit të disa aktiviteteve kulturore e artistike, por në mënyrë të veçantë tek "Mbrëmja Shkodrane", ku isha i ftuar. Ai ishte në krye të stafit organizator, por krejtësisht i veçantë, falë karakterit të tij për ta bërë gjithçka bukur e siç duhet e për ta çuar deri në fund me sukses.

Në rrjetet sociale në Amerikë, Rush Dragu ishte themeluesi i Portalit www.AlbDreams.Net, një website i pari në gjuhën shqipe e që i shërbente gjithë Komunitetit në Diasporë.

Ndërkohë që ky personalitet është i kudogjendshëm dhe i papërtushëm në veprimtarinë e tij gjen kohë të shkruaj, jo thjeshtë artikuj që boton në gazeta, por edhe libra me temë historike dhe letrare,

për të dhënë një kontribut në edukimin e bashkëatdhetarëve, por në mënyrë të veçantë të fëmijëve të tyre.

Këtë krijimtari e fillon që në Shqipëri, ku boton monografinë "Prek Cali, Legjenda e Maleve", si dhe librin "Kelmendi - dritëhije" me publicistikë historike.

Rush Dragu rreth 14 vjet bashkëpunon me revisten "Kuvendi" në Michigan dhe gazetar "Illyria" në New York.

Librat "Për të gjetur lirinë" me shkrime publicistike dhe libri "Nëntë ditët e ferrit për ty" me novela janë dy botimet e tij më të fundit.

Duhet nënvizuar se ai në Michigan ka drejtuar për dy vjet radion "Iliria", e cila emeton në gjuhën shqipe që në vitin 2004.

Rush Dragu për asnjë moment nuk i ka shkëputur lidhjet me atdheun. Bashkëpunon me mediat dhe gazetën shqiptare, ka lidhje me bashkëpunëtorët të vjetër e të rinj, por në mënyrë të veçantë me vendlindjen e tij, me Malësinë e Kelmendit, ku ka lindur dhe jetuar, aty ku në vitin 1998 ideoi atë aktivitet madhështor, kulturor e artistik të pagëzuar "Logu i Beshkëve" ku mbildhen figurat më të shquara të traditës dhe folklorit nga gjithë trevat shqiptare.

Rush Dragu nxori në Qafë Predelecit në Kelmend vajzat e bukura melësore për të performuar huret e tyre, rrobat e lashta të kësaj treve me pagëzimin aq domethënës "Miss Beshka". Këta aktivitete zhvillohen çdo vit, ku edhe ai vetë është aty jo thjeshtë si organizator, por edhe si donator.

Në vitin 2000 në qytetin e Shkodrës është ideator për vendosjen e Përmendores së Heroit të Kufirit Verior, Legjendës së Maleve, Prek Cali, falë dhe ndihmës financiare të diasporës kelmendase në Shtetet e Bashkuar të Amerikës.

Të gjitha këto unë i mësova nga fjalët e tij ku shpesh mbizotëronte modestia, por më shumë për të mësova nga bashkëatdhetarët tanë atje, të cilët e donin dhe e respektonin si një djalë të mirë të fisit që e duan të gjithë.

Në krye të shkrimit unë u shpreha se po shkruaj për Rush Dragun që puna e tij në Diasporë të bëhet sa më e njohur, ashtu siç bëhet e njohur veprimtaria dhe kontributi i shumë bashkëatdhetarëve tanë kudo nëpër botë dhe kjo më shtynë që të mbajë edhe një qëndrim kritik për mediat tona të fuqishme që i kanë të gjitha mundësitë që këto figura të na i sjellin sa më pranë, që publiku shqiptar t'i njohë e t'i nderojë.

Ramazan ÇEKA, Gusht 2016

LAMTUMIRË MALËSORI I MIRË PAL TULA

Plot 19 vite u bënë më 22 tetor, që një grup malësorësh, të cilët duken në foton kolektive që po botojmë, kushrinjë dhe të afërm midis tyre ndodhen në oborrin e shtëpisë së Mark Nikës, që është njëri prej tyre, për të përcjellur një familje që po largohej nga lagja e fshati për në qytet.

Ata janë, nga e djathta në të majtë,



Mhill Pjetra, Mark Nika, Pal Tula, Gjergj Prela, Mark Marashi, Gjëlosh Gjoka, Kolë Zeneli. Ashtu erdhi koha e ashtu u bë. A ishte mirë, apo jo mirë koha do ta vërtetojnë, për të gjitha ata që morën rrugët e botës në kërkim të një jete më të mirë, më të sigurtë. Përsosimisht, por edhe shumë nga ata që e shikojnë këtë fotografi ndjejnë respekt dhe mirënjohje. Më 22 shtator 2016 ndahet nga jeta edhe i vetmi që jetonte nga ky grup, Pal Tul Okseti.

Koha dhe jeta bëjnë të vetën. Kush është lindur do të ndahet një ditë nga kjo jetë. I lumtur shkon në botën tjetër ai që

len pas emrin e mirë e pasardhës të mirë. Të tillë persona nuk vdesin por, thjeshtë, vetëm vorrosen. Pal Tula u lind në Gjellaj të Thethit në vitin 1920, taman në trodhin e Shtëpisë së Lul Gjokës e përmendur shumë në të gjitha kohërat, që kur u formua familja e parë e saj, dhe vijon. Ai u lind dhe u rrit në ato troje ku hynin e dilnin burra të zgjedhur dhe të nderuar të fshatit dhe krahinës, ku hynte e dilte Dedë Gjo Luli e Bajram Curri e ku ndjeheshin të sigurtë.

Pal Tula, gjatë gjithë jetës së tij, jo të shkurtër, u dallua për cilësitë e tij të mira në shtëpi, në rrugë, ►



VALTER KODRA

U lind me 30 korrik 1990, në Breglumi, Shalë, ku kaloi fëmijërinë dhe ku u brumos karakteri i tij. Nevoja për arsimim e solli që në klasë të parë në Shkodër. Ka studiuar Gjuhë-Letërsi në Universitetin e Shkodrës. Dashuria e tij për poezinë është shfaqur që në fëmijëri, me vargëzimet e vjershave të para. Pjesëmarrës aktiv në aktivitete e takime letrare. Në 2009-ën fiton çmimin e dytë në një konkurs poetik të zhvilluar nga Gazeta "Di tutti i colori" në Cuneo, Torino, Itali. Fiton çmimin e dytë në "Festivalin e poezisë së pa botueme 4", ku tashmë është bërë i pandashëm nga ky festival poetik. Shkruan në gjenisht dhe sipas standardit të normës letrare.

PORTRET NATYRE!

Dua të marr një copë qiell, ta zbres në një pemë të harlisur vere e të pikturoj me fjalë një portret të grisur se ashtu ma nxjerr shpirti Do t'i marr pak ngjyrë hënës, pak natës e fshehtësisë së saj, kështu pikturova një fytyrë

ende të panjohur
që dalëngadalë merr trajten e zhgënjimit
Dua edhe ngjyren e dheut, për sytë,
që sa herë ta shoh t' më kujtohet nga erdha
e ku duhet të mbërrij...
Dielli, teksa u nis në rrugëtimin e tij të përjetshëm,
përendem...
më premtoj ngjyrën për të njohur vetveten,
e kështu u pikturova një portret natyre,
larg prej botës po aq sa prej shpirtit...

ME VETEN...

Unë ...
një rrugëtar i lodhur
nga ecja e gjatë
një kalimtar i pa vënë re
që dita ju bë natë,
dorë ngritur, në cep të rrugës
Njeri a më merr ?!
errësira po më tremb
diku dua të shkoj
se nata u err.
Ti ...
ecën me hap të sigurtë
drejt qëllimit tënd,
i ftohtë, i zbehtë, i ngurtë
as errësira s'të tremb

Të pyes;
Ku do të mbërrish ?
Përgjigjesh;
Atje ku më takon të jem.
Po ku duhet të jem unë
vallë a mund ta dish ?!
Unë qenkam pritja
ti qenke ikja...
Mbase takohemi atje
ku nuk ishim kurrë !

VJESHTA N' MUE

E kush ka than' se vjeshta
s'ka ngjyra ?!
Ajo ka tana ngjyrat e shpirtit tem,
prej te e kuqja e ndezun flak' jete,
tek e zeza si deri n' asht dhemb.
Ka tan' at' hijeshi si thell' nder mendime frymon,
ajër shprese si her' m'g'zon e her' m'trishton.
E dashtun vjesht' sa i g'jajm' njani-tjetrit,
t'gjykuem per munges'

ngjyrash,
mue per s'gjalli
ty per s'dekuni ...
Ti linde aty ku dita e nata
u shqyen me njena-tjetren
deri n'mosnjohje ,
e ku Dielli e Hana k'qyren vrant' .
Linde ne nji shkretin' shpirt'thithese
i denuem me pa shpirtin tan ka t'ik tinz'
, tue mos mujt' me e lidh
n'pemen e perjetesis' .

I SHKRETI TI!

Turresh mbas oazeve
me shue pak etje genesh,
e si i truem mbet
kur deshtimi i rralles t'kcen n'shpin
, e qeshet si dreqi me ty ,
e t'kallzon se gjithcka kje
fryt i nevojës tane ,
a ndryshe , mirazh .
Ti linde aty ku edhe qiellit
iu sosen lot tue kja ,
e je i lindun per lotsosje
ne kte shkretin' qe t'thith shpirtin.
Po e ndaj kete poezi me ata miq te cilet jane miq te per-
bashket me poezine...!

NDER-KOHE.

Nuk e diti askush
edhe pse nder-kohe
dyshuan ...
Si mund te pritej
mekati nga engjelli?!
Renden pas tij
te sflitur ne etje
nder-kohe sebashku
te gjithe mekatuan.
U perlyen te pafajshmit
dhe nder-kohe u motivuan
edhe engjelli ra ne mekat.
Nuk e diti askush
edhe pse nder-kohe
dyshuan...
Engjelli kishte lindur
mekatin t'iu mesonte.
Njerez te gjore
pa nder pa kohe...

◀ në punë, në luftë për çlirim kombëtar, në tubime e pleqime, në festa e gëzime, në ndihmën për të pa mundurit, në ceremonitë mortore, në ndeshje e përcjedhje të mikut e bijës, të kumbarës e ndrikullës, të shokut e rrugëtarit, të njohurit dhe të panjohurit.

Që në moshë të re, ndonëse vëlla i vetëm pasi i vdesin katër vëllezër në moshë të vogël e deri në 15 vjeç, ju kush-tua punës, por edhe jetës shoqërore të lagjes, fshatit e zonës. Ai qe djali i Tul Vatës dhe Mrikë Zefes, megjithëse i vetëm, por asnjëherë nuk u mënjanua asnjë veprimtarie familjare e shoqërore. Ishte i kudo gjendur, ishte bujar sa nuk ka ku shkon më tej. Axha i tij, Bashë Vata, ka qenë një burrë shumë i njohur në kohën e tij, dhe ka lënë prapa një familje të madhe dhe fisnike. Pal Tula bisedonte me të gjithë pavarësisht nga mosha, shkolla apo profesioni, jepte mendimin e vet qetë, dhe në mënyrë të menduar. Pali gjithnjë pati përkrahejn dhe mbështetjen e kushrinjëve dhe të afërmëve. Edhe pse djalë i vetëm asnjëherë nuk ishte dhe nuk e lanë vetëm. Por edhe ai dinte ti donte dhe ti respektonte gjithmonë.

Pal Tula martohet me Galë Dedë



Gjeloshin nga Curraj Epër, grua me të gjitha cilësitë e mira të malësore. Ata patën shtatë fëmijë, djem e vajza, dhe të gjithë ngritën familjet e tyre.

Ky njeri, ky burrë, me cilësitë nga më të mira të trodhit ku u lind, të fshatit e krahinës, ishte familjar i mirë, drejtues i shtëpisë i mirë, edukator i familjes i mirë, punëtor i mirë në të gjitha frontet ku kërkohet, sa në arat me misër, sa në tufën më dele, sa në livadh për ushqimin e bagëtive, sa në punët kolektive të lagjes apo fshatit. Ishte i pranishëm në festat familjare e zonale, në gueti e lojra kolektive të kohës. Megjithëse nuk dinte shkrim dhe këndim, ai kishte shumë "shkollë", mbante mend shumë, arsyetonte bukur dhe ishte i qartë në mendimet e tij. Në tërësinë e tij ishte, ashtu siç përdoret në

popull për njerëz të till, "burrë Orëmadh".

Duke u kthyer në kohë dhe duke kujtuar ata që janë larguar nga kjo jetë, edhe pse koha kalon, të duket se i ke të gjallë përpara, se i ke pranë, se mund të bisedosh me ta. Është ashtu, sikur malet, që sa më shumë u largohesh i dallon më mirë e që të nxisin dëshirën për ti parë vazhdimisht. Kështu ngjan edhe me Pal Tulën. Ky burrë i nderuar meriton shumë, për vlerat e tij në të gjitha drejtimet. Njerëz të till kurrsesi nuk duhet dhe nuk do të harrohen, gjatë, shumë gjatë, jo vetëm nga familjarët e të afërmit por edhe shumë më gjerë, sepse të tilla kanë vlerat jo vetëm për të afërmit, por për një bashkësi më të gjerë, brenda dhe jashtë krahinës.

Respekt duhet treguar për të gjitha ata që nuk kemi nevojë të pyesim, nëse dikush

na pyet për ta, se pse po pyet, pasi nuk kanë lënë prapa njolla të pakëndshme, përkundrazi jemi kryelartë e ballëhapur, na bëjnë krenar. Koha do të vazhdojë të ecë, por, ajo nuk do të arrijë dhe nuk do ta kenë mundësinë që të largojë e fshijë bëmat dhe kujtimet për ta siç është edhe rasti i Pal Tulës apo atyre burrave që lan gjurmë të pashlyera në histori. Njerëz të tillë mbeten shembull për brezat.

Pal Tula ishte si një arkiv i gjallë, mbante mend shumë dhe nuk përtonte ti shfaqte. Në këto pak fjalë paraqitem një pjesë të jetës dhe punës së tij, respektin që tregonte për të tjerët, me njerëzit e për njerëzit dhe për këtë edhe vlerësohej shumë.

Pal Tula u përcollë nga familjarët, të afërmit, miq e shokë, bashkëfshatarë e bashkëkrahinar të shumtë, me të gjitha nderimit që i takojnë një burri si ai. Ai do të na mungojnë, por ngushëlohem sepse qe njeri me shumë vlera, i nderuar dhe i respektuar nga të gjithë, qe i nevojshëm për familjen dhe shoqërinë, por puna dhe mësimet e tij do të jenë të nevojshme edhe për të ardhmen. Ai qe dhe do të kujtohet si i veçantë, në kuptimin e plotë pozitiv të fjalës.

Luigj SHYTI



MIMOZA REXHVELAJ

Ka lindur në Fier më 21.01.1981 dhe është rritur mes Durrësit dhe Malësisë së Madhe. Ka studiuar për Gjuhë-Letërsi, me profesion mësuese. Diplomuar për Gjuhë-letërsi dhe Mastër ne Universitetin e Shkodrës për "Etnokulturë"; vazhdon në vitin e tretë të Fakultetit të Drejtësisë. Është autore e tre librave me poezi dhe një studimi letrarë përkatësisht: "Dashuri ti je mëkati im", "Fshima lotin", "Jepi fjalës kohë", autore e studimit "Vështrim mbi poezinë e Diasporës". Në vitet e fundit ka botuar herë pas here në shtypin letrar të kohës dhe është përfshirë në disa antologji poetike si në atë me titull "Korsi i hapur" 1, 2, 3 - botim i Pegas-it, "100 poetë për dashurinë", "Struga 2012". Andrologji "Sabbat", si edhe tek "Fluturim Pulëbardhash" ku u vlerësua me mirënjohje. Vlerësuar ndër vite me çmimet: "Penda e Artë e Migjenit", "Ibrahim Rugova" në Istog, "Mirënjohje" Takimi i Poeteshave, "Mirënjohje" Takimet letrare në Ulqin, titulli "Poete e talentuar" nga revista "Fjala", "Poete e psikologjisë dhe performancës poetike" "Pegas Albania".

ODISEJADA

Duart vendos mbi pllakat homerike,
Të zbritura nga lart, urdhësesat pa urdhër,
njeriun e lëshuar si pré
në arenën e luanëve,
në arenën e shumë zotave .
Është jeta . Odisejada ime .
Duhet t'i bindem.
Nuk pres shumë nga zhurma e dallgës
që përplasat mbi rërë,
As nga pulëbardha që lajmëron tokë,
e as nga lajmi i fundit i gjetur në shishe
dy mijë vjet më vonë...
Tani lëri retët të vazhdojnë rrugëtimin qiejsh,
ngrij velat e tua në direk.
Mbushe me ajër kraharorin
dhe ec, ec, ec ...
Vetëm ec ...
S'duhet ta dëgjosh thirrjen e sirenavë ...
Lëre pas krahëve,
mos i ndaj sytë nga lind dielli mbi kreshtë.
Nganjëherë
Nganjëherë jeta ngec pas teje
Si ferra, pas flokëve
Dhe nuk të shqitet.
Hyre atje ku s'duhej!
Nuk e di se si
Dhe as se pse

Ajo të ngre kurthe,
Kurthe asgjëje.
Muskujt pasivë të trupit
Papritur, gjallërohen
Duke zbuluar një tjetër ego,
Një ngjyrë të verdhë
Që stina e ngrohtë e mban latente.
Muskujt e qafës tendosen,
Këtë herë jo për të mbajtur peshë,
Por, për të parë qartë.
Prespektiva është një iluzion,
Ajo pemë e zvogëluar dhjetëra herë,
Është një iluzion , po kështu rruga,
mulliri, një konstelacion botësh që presin të zbulohen ...
I tillë është edhe gisht i tregon .
Frika të pushton, fundi i egëzistencës.
Me një kërcitje dhëmbësh zgjohesh.
Dielli rezaton mbi fytyrën e zhubrosur si mësalla pas feste.
Por, neser do të kthehet sërish në vend.

Jeta vazhdon në lojen e saj
Ditë-natë, natë-ditë,
me dublime të njëpasnjëshme,
të rregullta mbi parket duke na përgatitur
për momentin e gjuajtjes,
nëse ai moment vjen ndonjëherë

VAJTOJE SERENATËN, KITARË

I premtove shpirtit një serenatë,
Me kitarën e vjetër të harresës,
Kumbon vaji, zërave të natës
Puhizë mbetur, shtegtare e largët.
Trupi i kitarës së pa prekur
i varur në gozhdë, murin ledhaton
Martir i dashurisë së fjetur
Tingull i vrarë, këngëzen më zgjon.

Murg në manastirin e kujtimeve
struket bosh, shpresa melodioze
Shuhet mes qirinjve të kishës
Për dikë, luten sorrat zëcjerrë....

Shpirti i zgjat dorën premtimit
Serenatën vajtoma, zemër e kitarës.
Mes gurve të varrit, simfonia
gulçon heshtjen e zurmëshme
Tingujt shuhën...
Nën dritën e hënës...
Këndoma serenatën
kitarë!
Paqshëm të tremem
mes tingujve të latuar...

U LUTA PËR TY

U luta për ty.
Me forcën që fluturon
hapsirave të shpresës...
Dhe fryma e shenjt
si flad i ëmbël
me ledhatoj me mirësi.
U luta për ty
vetmija flaku zemërimin
si bishe e zgjebosur
e shpirti im puthi
ngrotësinë e pajtimit
u luta për ty
Ndeza njëmijë e një qirinj
njëmijë e një endrra,
harrove njëmijë e një perralla të frikshme.
po ti...

do të lutesh një ditë për mua!

EKSTAZË

Ndizini zjarret e shpirtit,
Mos kini frikë - hapini portat
Shkundini pluhurat
Mbushni gotat!
Jam uragan sonte.
Jam e çmendur, llahtari,
Dashuria më bën
me krahë në kaltërsi.
Me flatrat e jetës sulmoj
Asgjë s'më ndal.
Kam lindur me yllin e fatit
Qëndisur në ballë.
Ejani dhe ju me mua
në qiellin e shtatë.
S'do lëmë gur dashurie
Pa kthyer mbrapsht.

ASGJË E RE

Asgjë e re,
Veç fishkëllima monotone e fletës që kthehet,
Meridianëve të humbur
Mbuluar me pluhura.
Gjurmoj...
Kthesën e fundit në pentagram
Si gjethe me krahë ere fluturojnë
Minutat bosh.
Ora mban frymën me ritmin e zemrës
Tingull trishtimi
Varur mbi buzeqeshjen-gozhdë,
Në cep të buzës.
Asgjë e re
Në horizont . . .

Sot

Sot e pashë sërish atë djalë i parritur
Dhe të rritur para kohe,
Atë statujë skamjeje
Që tërheq më tepër se gjithkush.
"Zotni , sa don?
Prit, të bajmë pazar...!"
Aereola e njeriut të pafat, kurora e tij me gjemba nuk
hiqet kurrë nga koka,
As kur dremit.
Emrin nuk ia di, por, ai është gjithashtu një mbret sovran,
Në tokën pa zot
Të pamundësisë!

BABIT

Në kërkim të imazhit tënd,
Humba në skutat e rrudhave.
Varka letre mbyten në detin e syve . . .
Cigaren kafshon me buzët e trashura me kallo
Nga pauzat e gjata midis fjalëve
Dhe sapo kujtoj se po hy ne mendjen tënde
Filli këputet ,ne mbesim prap dy skaje.
Por, kur rrëshqas ndër valë e përplasem brigjesh. . .
Zëri yt më rri pas, më mbron shpatullat
'Boxh! Të ka babi djalë!'
Cila përendi ta bën udhëtimin të lehtë:
E uji, stuhisë, e luftes apo e mallit për te gjallët?
Numeroj hapat e tu të shpejtë
Nga dy e tre shkallë njëherazi,
Frymëmarrjen e zënë "mat" midis tyre,
Dhe fëmijën e zënë "mat" brenda burrit.
Në mbrëmjen e njomur nga vesa
Pres kthimin tënd ulur në prag
E njëjta përendi që të merr prej meje,
Të kthen sërish tek unë, në Itakë.

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra,
Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh PRODUCTION Kimay
Produzione Giacche

